



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**RREGULLORE  
PËR  
ZBATIMIN E REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË  
PËRGJITHSHËM**

Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të AKEP, nr. 10 datë 31.03.2026

Në mbështetje të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

## **KËSHILLI DREJTUES I AKEP VENDOSI:**

### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që nëpërmjet zbatimit të regjimit të autorizimit të përgjithshëm të promovohet konkurrenca dhe nxitja e investimeve për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe garantimi i ofrimit të tyre në përputhje me kërkesat ligjore dhe mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve.

#### **Neni 2 Objekti**

Objekti i rregullores është përcaktimi i rregullave për zbatimin e procedurës për njoftimin e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe përcaktimi në mënyrë të hollësishme i:

- a) formës dhe përmbajtjes të njoftimit dhe dokumentacioni mbështetës;
- b) regjistrimit dhe çregjistrimit të sipërmarrësit;
- c) kushteve të përgjithshme dhe kushteve specifike të autorizimit të përgjithshëm, për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të njoftuara.
- d) formës dhe përmbajtjes të Regjistrimit të Sipërmarrësve të regjistruar në AKEP.

#### **Neni 3 Përkufizime**

Termet e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, por pa u kufizuar, si më poshtë:

1. “Autorizim i përgjithshëm” është një akt i natyrës së përgjithshme, që përbëhet nga kuadri ligjor, i përcaktuar nga ky ligj dhe rregullat e nxjerra nga AKEP-i në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrimet specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, sipas këtij ligji.

2. “MVNO”, është një ofrues i shërbimeve të komunikimeve elektronike që ofron shërbime nën markën e vet, duke përdorur infrastrukturën e një operatori të autorizuar përmes një marrëveshjeje akses/interkoneksioni, pa zotëruar rrjet radio të vetin.
3. “Sipërmarrës” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, që ofron rrjete të komunikimeve elektronike ose shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit për komunikimet elektronike në fuqi.
4. “Ofrimi i një rrjeti të komunikimeve elektronike” është ndërtimi, operimi, mbikëqyrja ose bërja e disponueshme e një rrjeti të tillë.
5. “Ofruesi i shërbimit të komunikimeve publike” është sipërmarrësi që ofron shërbime komunikimi publik, duke siguruar akses te një operator i rrjetit të komunikimeve publike.
6. “Rrjet i komunikimeve elektronike” janë sistemet e transmetimit, të bazuara ose jo mbi një infrastrukturë të përhershme ose mbi kapacitete administrimi të qendëruar dhe, kur është e aplikueshme, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, përfshirë elementet e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse tokësore, me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin, rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kabllave elektrike, në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe rrjetet kabllore televizive, pavarësisht nga tipi i informacionit që përcjell.
7. “Rrjet i komunikimeve publike” është një rrjet i komunikimeve elektronike, që përdoret tërësisht ose kryesisht për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun dhe që mbështet transferimin e informacionit ndërmjet pikave fundore të rrjetit.
8. “Shërbim i komunikimeve elektronike” është shërbimi i kryer kundrejt një pagese, i përfutur nëpërmjet rrjetit të komunikimeve elektronike, i cili, duke përjashtuar shërbimet që ofrojnë ose ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së transmetuar, duke përdorur rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, përfshin llojet e mëposhtme të shërbimeve:
  - a) “Shërbim akses në internet” është shërbimi i komunikimit elektronik, i disponueshëm për publikun, që ofron akses në internet dhe në këtë mënyrë lidhje me pothuajse të gjitha pikat fundore virtuale të internetit, pavarësisht nga teknologjia e rrjetit dhe pajisjet fundore të përdorura;
  - b) “Shërbim i komunikimit ndërpersonal” është shërbimi i ofruar normalisht kundrejt një pagese, që mundëson shkëmbimin e drejtpërdrejtë ndërpersonal dhe ndërveprues të informacionit, nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, ndërmjet një numri të kufizuar personash, ku personat që iniciojnë ose marrin pjesë në komunikim përcaktojnë marrësit e tij. Ky shërbim nuk përfshin shërbimet që mundësojnë komunikimin ndërpersonal dhe ndërveprues, thjesht si një veçori ndihmëse e vogël, e lidhur në mënyrë të brendshme me një shërbim tjetër;
  - c) shërbimet që konsistojnë tërësisht ose kryesisht në përcjelljen e sinjaleve të tilla, si shërbime transmetimi që përdoren për ofrimin e komunikimeve makinë – makinë dhe për transmetime radiotelevizive.
9. “Shërbim i komunikimit ndërpersonal i bazuar në numër” është një shërbim komunikimi ndërpersonal, i cili lidhet me burimet e numeracionit të caktuara publikisht, sikurse me një numër ose me numra të planit kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit, që mundëson komunikimin me një numër tjetër ose numra të planit kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit.

10. “Shërbim i komunikimit ndërpersonal i pavarur nga numri” është një shërbim komunikimi ndërpersonal, i cili nuk lidhet me burimet e numeracionit, të caktuara publikisht, sikurse me një numër 7 ose numra të planit kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit ose që nuk mundëson komunikimin me një numër apo numra të planit kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit.
11. “Shërbimi universal” është një minimum i përcaktuar shërbimesh publike të komunikimeve elektronike, të një cilësie të caktuar, me çmime të përballueshme për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike.
12. “Shërbim me vlerë të shtuar” është një shërbim informacioni, i ofruar përmes numrave me tarifë premium, me ndarje kostosh ose numrave të gjelbër, nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve elektronike, normalisht përkundrejt një pagese.
13. “Transmetim radioteleviziv”, është transmetimi i programeve të shërbimeve të radios dhe televizionit nëpërmjet një antene tokësore, rrjeti të komunikimeve elektronike ose satelitore, në formë të koduar ose jo, për t’u marrë nga publiku.
14. “Cënim i të dhënave personale” është çdo cënim i sigurisë, që mund të shkaktojë në mënyrë aksidentale ose të paligjshme shkatërrimin, humbjen, ndryshimin, përhapjen ose aksesin e paautorizuar të të dhënave personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara në ndonjë mënyrë tjetër për ofrimin e një shërbimi të disponueshëm të komunikimit elektronik për publikun.
15. “Interkoneksion” është lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të komunikimit, të cilat përdoren nga i njëjti operator apo operatorë të ndryshëm, në mënyrë që t’i lejojë përdoruesit e një operatori të komunikojnë me përdoruesit e të njëjtit operator ose të një operatori tjetër ose të lejojë aksesin për shërbimet e ofruara nga një operator tjetër. Shërbimet mund të ofrohen nga palët e përfshira ose palët e tjera që kanë akses në rrjet. Interkoneksioni është një lloj i veçantë aksesi, që zbatohet ndërmjet operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit.
16. “Shërbim emergjence” është një shërbim, sipas legjislacionit në fuqi, për mbrojtjen civile për ofrimin e shërbimeve emergjente dhe të asistencës, që ofron ndihmë të menjëhershme dhe të shpejtë, para dhe gjatë një fatkeqësie ose menjëherë pas saj, për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore për mbijetesë të njerëzve të prekur.
17. “Numrat e shërbimeve të emergjencës” janë numrat e përcaktuar në planin kombëtar të numeracionit për shërbimet e emergjencës për policinë, zjarrfikësit, numrat e emergjencës për shërbimet shëndetësore, shërbimet lajmëruese dhe ato të deklaruara, përfshirë numrin e unifikuar evropian të thirrjeve të emergjencës “112”.
18. “Plani Kombëtar i Frekuencave” është dokumenti i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, që përcakton brezat e frekuencave për shërbime të ndryshme të radiokomunikimit dhe vendos kushtet bazë për caktimin dhe përdorimin e frekuencave për përdorimin me efektivitet të spektrit të frekuencave dhe shmangien e interferencave.
19. . “Plani i numeracionit” është struktura e numrave dhe e serive të numrave, si dhe caktimi i tyre për sigurimin e aksesit në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike.
20. Sistemi i aksesit të kushtëzuar” është çdo masë teknike, sistem autentifikimi ose rregullimi, ku aksesi në një shërbim të mbrojtur të transmetimit radio ose televiziv, në formë të kuptueshme, kushtëzohet me abonim ose një formë tjetër të autorizimit paraprak individual.
21. “Zyra kompetente e broadband-it” është struktura e krijuar në varësi të ministrit për nxitjen e zhvillimit të rrjeteve broadband, përfshirë rrjetet e shpejtësisë shumë të lartë të komunikimit.

## Neni 4 Fusha e zbatimit

1. Çdo sipërmarrës është i lirë të ofrojë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 54/2024.
2. Rregullat e përcaktuara në këtë rregullore janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga cilido sipërmarrës, që ofron rrjete dhe/ose shërbime të komunikimit elektronik, në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Njoftimi dhe zbatimi i procedurave të përcaktuara në këtë rregullore është i detyrueshëm edhe për subjektet e ligjit nr. 97/2013 “Për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për të cilët ofrimi i rrjeteve për transmetimet audio dhe/ose audiovizive, kërkon ose nuk kërkon përdorimin e frekuencave që administrohen nga AKEP.
4. Ofrimi i rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike nga sipërmarrësit, mund të kufizohet nga AKEP, kur kjo është e nevojshme për arsye të:
  - a) interesit publik;
  - b) sigurisë publike;
  - c) shëndetit publik.
5. Çdo kufizim në ofrimin e rrjeteve dhe komunikimeve elektronike, argumentohet, i njoftohet Ministrisë së linjës dhe publikohet paraprakisht në faqen zyrtare të AKEP.
6. Për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga autorizimi i përgjithshëm, sipërmarrësi nuk ka nevojë për marrjen e ndonjë vendimi apo akti administrativ nga AKEP.
7. Dispozitat e kësaj rregulloreje, nuk zbatohen për shërbimet e komunikimit ndërpersonal të pavarura nga numrat.

## KREU II REGJIMI I AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM

### Neni 5 Forma, procedura e njoftimit dhe dokumentacioni shoqërues

1. Çdo sipërmarrës që synon të ofrojë rrjete apo shërbime të komunikimit elektronik në territorin e Republikës së Shqipërisë të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve ndërpersonale që nuk bazohen në numra, ka detyrimin të njoftojë në AKEP në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit 54/2024, si dhe me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Lista e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të cilat mund të ofrohen sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm, përcaktohet në **Aneksin 1**, bashkëlidhur rregullores. Kjo listë mund të ndryshojë në varësi të rrjeteve dhe shërbimeve të reja që mund të hyjnë në treg në fushën e komunikimeve elektronike.
3. Njoftimi nga sipërmarrësi, bëhet përmes plotësimit të Formularit të Njoftimit në sistemin e aplikimeve online, e cili aksesohet në faqen ëeb të AKEP [ëëë.akep.al](http://ëëë.akep.al). Informacioni i kërkuar dhe formati i njoftimit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, paraqiten në **Aneksin 2** të kësaj rregulloreje. Kur sistemi i aplikimeve online është në proces teknik përmirësimi, përditësimi, mosfunksionimi, etj., formulari i njoftimit dhe dokumentacioni shoqërues, dorëzohen në AKEP në formë shkresore. Ky përcaktim është i vlefshëm dhe në rastin e regjistrimit të sipërmarrësve sipas nenit 15 të kësaj Rregulloreje.

4. Njoftimi përmban të dhënat si më poshtë:
  - a) emrin, adresën e selisë kryesore të sipërmarrësit dhe sipas rastit, çdo adresë dytësore;
  - b) të dhënat e regjistrimit ligjor të sipërmarrësit, statusin ligjor, formën dhe numrin e regjistrimit.
  - c) personin e kontaktit dhe të dhënat e kontaktit të sipërmarrësit;
  - d) adresën e faqes web të sipërmarrësit, që lidhet me ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;
  - e) përshkrimin e shkurtër të rrjetit ose shërbimit të komunikimeve elektronike që do të ofrojë, sipas përcaktimeve të parashikuara në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje;
  - f) datën kur është parashikuar fillimi i ofrimit, ndryshimi ose përfundimi i shërbimit; shtrirjen gjeografike të rrjetit dhe shërbimeve që do të ofrohen, e cila do të jetë minimumi një njësi administrative.
  - g) deklaratën për datën, brenda së cilës sipërmarrësi përfundon ndërtimin e rrjetit ose fillon ofrimin e shërbimeve të tij.
5. Njoftimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, përmban gjithashtu:
  - a) deklaratën se informacioni është i saktë, si dhe
6. deklaratën se sipërmarrësi zotëron kapacitetet teknike, ligjore dhe financiare të nevojshme dhe do të zbatojë detyrimet ligjore. Deklarata shoqërohet me dokumentacionin mbështetës nw Aneksin nr.2, Tabela 5.
7. Kur njoftimi është i plotë dhe në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, AKEP, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit, kryen regjistrimin e njoftimit në Regjistrin e Sipërmarrësve dhe e njofton aplikuesin me shkrim për dërgimin në AKEP, të kopjes së Formularit të Njoftimit Online, së bashku me dokumentacionin shoqërues origjinal, të nënshkruar nga aplikuesi.
8. Kur njoftimi është jo i plotë, bazuar në kërkesat e pikave 4 dhe 5 të këtij neni, AKEP-i njofton aplikuesin brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga data e aplikimit për plotësimin e mangësive në dokumentacion. Nëse aplikuesi nuk e plotëson dokumentacionin e kërkuar brenda 15 ditëve, AKEP-i njofton me shkrim aplikuesin se nuk do ta regjistrojë atë. Kundër këtij njoftimi aplikuesi ka të drejtë të ankohet në Këshillin Drejtues të AKEP.  
AKEP kur vlerëson të nevojshme, bashkëpunon me institucionet kombëtare përgjegjëse për verifikimin e përputhshmërisë së të dhënave dhe dokumentacionit të njoftuar dhe depozituar nga sipërmarrësit sipas kësaj rregulloreje.
9. Nëse AKEP nuk konfirmon me shkrim, brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 6 të këtij neni, ose nuk kërkon plotësimin e dokumentacionit sipas pikës 7 të këtij neni, njoftimi dhe regjistrimi konsiderohen të përfunduar.
10. Sipërmarrësi duhet të depozitojë në AKEP brenda 3 muajve nga data e fillimit të ofrimit të shërbimit dokumentacionin si më poshtë:
  - a. Kontratat e punës së personelit teknik dhe atij përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e rrjetit/infrastrukturës së komunikimeve elektronike, shoqëruar me dokumentacionin që vërteton edukimin dhe kualifikimin profesional të tyre, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 10, Tabela 5, Aneksi 2.
  - b. Vërtetim të pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore vetëm për personelin e sipërpërmendur.

## **Neni 6**

### **Certifikata e Konfirmimit**

1. AKEP, konfirmon regjistrimin e njoftimit të sipërmarrësit në bazën e të dhënave elektronike për ofrimin e rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, nëpërmjet Certifikatës së Konfirmimit (CK).
2. Modeli tip i Certifikatës së Konfirmimit për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike sipas rregullave të parashikuara në ligjin nr. 54/2024 dhe për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete për transmetime audiovizive sipas ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet në Aneksin 3 të kësaj rregulloreje”.
3. Certifikata e Konfirmimit tërhiqet fizikisht nga sipërmarrësi pranë zyrave të AKEP, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit nga AKEP dhe pasi të ketë depozituar kopje të dokumentacionit shoqërues, sipas pikës 6 të nenit 5 të kësaj rregulloreje.
4. Certifikata e Konfirmimit, për efekt vlefshmërie, përmban të dhënat si më poshtë:
  - a) stemën e Republikës së Shqipërisë dhe emërtimin e institucionit që e lëshon (AKEP);
  - b) emërtesën: Certifikatë e Konfirmimit, datën dhe numrin përkatës,
  - c) emrin e titullarit që e lëshon, nëshkrimin e tij dhe vulën e institucionit;
  - d) rrjetin dhe /ose shërbimet e regjistruara që autorizohen të ofrohen;
  - e) kushtet e përgjithshme të detyruara për zbatim në varësi të llojit të rrjetit dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike që ofrohen;
  - f) informacionin mbi regjistrimin në bazën e të dhënave elektronike;
  - g) Elementin /QR \_Code”.
5. Për ndryshime në informacionin e njoftuar nga sipërmarrësi, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, në Certifikatën e re të Konfirmimit që do të lëshohet nga AKEP, në faqen e parë të saj, vendoset shënimi: “*Për konfirmimin e regjistrimit të njoftimit datë xx. yy. zzzz (data, muaji, viti) mbi ndryshimin/et e ndodhura në të dhënat e regjistruara sipas CK Nr , datë xx.yy.zzzz, të CK pararendëse)*”, si dhe reflektohen ndryshimi/et e ndodhura të njoftuara, në faqen/et vijuese.
6. Certifikata e Konfirmimit, lëshohet në 2 (dy) ekzemplarë origjinalë, 1 (një) për sipërmarrësin dhe 1 (një) kopje për AKEP.
7. Vlefshmëria e Certifikatës së Konfirmimit lëshuar nga AKEP, përfundon me ç’regjistrimin e sipërmarrësit sipas rasteve të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 7**

### **Njoftimi i ndryshimeve**

1. Sipërmarrësit e regjistruar në bazën e të dhënave elektronike, janë të detyruar të raportojnë të gjitha ndryshimet në informacionin e deklaruar më parë pranë AKEP, brenda 30 ditëve nga ndodhja e tyre.
2. Konsiderohen ndryshime në informacionin e paraqitur edhe ndryshimet që lidhen me:
  - a) ofrimin e rrjeteve dhe /ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;
  - b) zonës së ofrimit të rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike.
  - c) të dhënat e deklaruar (vendndodhje, person kontakti, përfaqësues ligjor etj).
3. Raportimi i ndryshimeve nga sipërmarrësi, kryhet sipas të njëjtës procedurë që zbatohet për

njoftimin. Përveç rastit të njoftimit për mbylljen e plotë të ofrimit të rrjetit ose shërbimeve elektronike të regjistruara në bazën e të dhënave elektronike, konfirmimi i regjistrimit të ndryshimit/ve të ndodhura kryhet nga AKEP duke amenduar Certifikatën e Konfirmimit, të lëshuar për regjistrimin fillestar, sipas ndryshimeve të ndodhura dhe të njoftuara, për rastet e parashikuara në pikën 2, geramat a dhe b, të këtij neni.

## **Neni 8** **Pagesat administrative**

Çdo sipërmarrës që ofron rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm, me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, do të paguajë pagesat dhe tarifat e përcaktuara në ligjin nr. 54/2024, si dhe tarifat administrative të miratuara me vendimin nr. 13, datë 27.08.2025 të Këshillit Drejtues “Mbi caktimin e pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga AKEP”.

## **Neni 9** **Çregjistrimi**

1. AKEP bën çregjistrimin me kërkesën e vetë sipërmarrësit, kur ai njofton ndërprerjen e aktivitetit. Njoftimi për çregjistrim bëhet nga sipërmarrësi, duke plotësuar Formularin e Njoftimit në sistemin e aplikimeve online. AKEP, konfirmon me shkrim çregjistrimin e sipërmarrësit, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit të ndërprerjes. Në rastet kur sistemi i aplikimeve online është në proces teknik përmirësimi, përditësimi, mosfunksionimi, etj., formulari i njoftimit për çregjistrim dorëzohet në AKEP në formë të printuar.
2. AKEP bën çregjistrimin e sipërmarrësit me nismën e tij, kur:
  - a) konstatohet mbyllja, pezullimi i aktivitetit të sipërmarrësit ose nëse sipërmarrësi nuk ka filluar ofrimin e shërbimeve, brenda nje afati prej 12 muaj nga data e deklaruar në aplikimin e njoftimit të sipërmarrësit.
  - b) në zbatim të një vendimi përfundimtar të gjykatës;
  - c) në zbatim të një vendimi administrativ, për shkaqe të parashikuara në ligjin nr. 54/2024 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
3. Vendimi për shkaqe të bazuara në ligjin nr. 54/2024 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, për çregjistrimin e sipërmarrësit duke i hequr të drejtën e ofrimit të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike merret nga Këshilli Drejtues i AKEP, mbi propozimin e inspektorit/ve të AKEP. Ky vendim është i ankimueshëm në rrugë gjyqësore sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të ndryshuar si dhe në ligjin nr. 54/2024.
4. AKEP, për rastet e parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni kryen verifikimin e përmbushjes së të gjitha detyrimeve financiare dhe ligjore të përcaktuara në autorizimin e përgjithshëm dhe njofton sipërmarrësin për shlyerjen e detyrimeve financiare të papërmbushura nëse ka të tilla.
5. Në rastet e çregjistrimit sipas këtij neni, AKEP kryen përditësimin e bazës së të dhënave elektronike sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore.

## **Neni 10**

### **Baza e të dhënave elektronike**

1. Për sipërmarrësit të cilët kanë njoftuar sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, AKEP krijon dhe administron një bazë të dhënash elektronike e cila përmban informacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni. Baza e të dhënave është e disponueshme për publikun në faqen zyrtare të AKEP.
2. Baza e të dhënave elektronike për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike dhe sipërmarrësit që ofrojnë rrjet të komunikimeve elektronike për qëllime të transmetimit të programeve audio dhe/ose audiovizive do të përmbajë informacionin sipas **Aneksit 4**, si më poshtë:
  - a) Emrin e sipërmarrësit, të dhënat e regjistrimit ligjor të tij, formën dhe numrin e regjistrimit (NIPT).
  - b) adresën gjeografike të degës kryesore të ofruesit dhe, sipas rastit, të çdo dege dytësore;
  - c) rrjetet/shërbimet që do të ofrohen nga sipërmarrësi;
  - d) shtrirjen gjeografike të rrjetit dhe shërbimeve që do të ofrohen dhe, sipas rastit, së bashku me vendet e tjera që mbulohen, përveç Republikës së Shqipërisë;
  - e) adresën e faqes ëeb të ofruesit, që lidhet me ofrimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, aty ku është e disponueshme.

## **Neni 11**

### **Kushtet e përgjithshme të autorizimit të përgjithshëm**

1. Kushtet e përgjithshme të Autorizimit të Përgjithshëm përcaktohen në Aneksin 5 të kësaj Rregulloreje dhe janë përmbledhur si më poshtë:
  - a) Kryerja e pagesave administrative në përputhje me nenin 18 të Ligjit 54/2024 dhe/ose tarifave për të drejtat e përdorimit të burimeve të kufizuara sipas Ligjit në fuqi;
  - b) Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë në komunikimet elektronike
  - c) Përmbushja e detyrimeve të njoftuara në AKEP me Formularin e Njoftimit, përfshirë detyrimet që rrjedhin nga vetëdeklarimi.
  - d) Ruajtja dhe administrimi i të dhënave për qëllime të ndjekjes penale dhe të sigurisë kombëtare.
  - e) Lejimi i përgjimit nga autoritetet kombëtare kompetente.
  - f) Kushtet e përdorimit nga autoritetet publike të komunikimeve për publikun e gjerë, për paralajmërimin e publikut nga rreziqe të afërta dhe për masat e shmangies së katastrofave të mëdha.
  - g) Kushtet e përdorimit gjatë fatkeqësive të mëdha ose emergjencave kombëtare për të siguruar komunikimin ndërmjet shërbimeve të emergjencave dhe autoriteteve;
  - h) Numeracioni për shërbimet e thirrjeve të emergjencës;
  - i) Detyrimi për të ofruar akses sipas përcaktimeve në ligjin nr. 54/2024, që zbatohen për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike;
  - j) Masat e projektuara për të siguruar përputhjen me standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve të përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 54/2024;
  - k) Detyrimi për transparencë ndaj ofruesve të rrjeteve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, për sigurimin e ndërlidhjes pikë fundore-pikë fundore, në përputhje me objektivat e nenit 5 të Ligjit 54/2024 dhe kur është e nevojshme dhe

proporcionale detyrimin për akses në informacionin që është i nevojshëm për verifikimin e saktësisë së këtij kushti;

- l) Shërbimi Universal kur është e aplikueshme;
  - m) Mbrojtja e mjedisit, planifikimi territorial, aksesit në pronat e paluajtshme, bashkëvendosja ose përdorimi i përbashkët i pajisjeve.
  - n) Detyrimin për lejimin e inspektimit
2. Kushtet e përgjithshme të vendosura në autorizimin e përgjithshëm sipas Aneksit 5, të kësaj rregulloreje janë objekt rishikimi nga AKEP, në varësi të ndryshimeve që pëson kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi. Ndryshimi i kushteve të përgjithshme kryhet nëpërmjet zbatimit të një procedure këshillimi publik me palët e interesuara në përputhje me nenet 37 dhe 44 të ligjit nr. 54/2024.

## **Neni 12**

### **Kushtet specifike të autorizimit të përgjithshëm**

1. Kushtet specifike të cilat i bashkëlidhen një autorizimi të përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve komunikimeve elektronike janë, si më poshtë vijojnë:
  - a) detyrimi për interkonektimin e rrjeteve sipas përcaktimeve ligjit nr. 54/2024;
  - b) masat për mbrojtjen e shëndetit publik kundrejt fushave elektromagnetike, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e ICNIRP-së për kufizimin e ekspozimit ndaj fushave elektromagnetike, për mbrojtjen e njerëzve të ekspozuar në fushat elektromagnetike, kur këto kushte janë të ndryshme nga ato të përfshira në autorizimin e përgjithshëm;
  - c) mirëmbajtja dhe integriteti i rrjetit të komunikimeve elektronike, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, për parandalimin e interferencave elektromagnetike, ndërmjet rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;
  - d) siguria e rrjeteve publike kundrejt aksesit të paautorizuar në përputhje me përcaktimet e kreu XIX të këtij ligji;
  - e) kushtet e përdorimit të frekuencave, sipas përcaktimeve në rregullin teknik për kërkesat thelbësore për pajisjet radio, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, kur përdorimi i frekuencave nuk është subjekt i autorizimit individual, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
2. Kushtet specifike të cilat i bashkëlidhen një autorizimi të përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, me përjashtim të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri, janë:
  - a) ndërveprueshmëria e shërbimeve në përputhje me ligjin nr.54/2024;
  - b) aksesimi nga përdoruesi fundor i numrave sipas Planit Kombëtar të Numeracionit, numrave nga numrat universalë ndërkombëtarë të telefonave falas (UIFN) dhe, kur është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, nga planet e numeracionit, sipas kushteve në përputhje me këtë ligj;
  - c) rregullat specifike të mbrojtjes së konsumatorit për sektorin e komunikimeve elektronike, duke përfshirë sigurimin e aksesit për përdoruesit me aftësi të kufizuara;
  - d) respektimi i kufizimeve në lidhje me transmetimet e përmbajtjeve të paligjshme ose përmbajtjes së dëmshme, bazuar në legjislacionin në fuqi.
3. Kushtet specifike të autorizimit të përgjithshëm, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, vendosen nga

AKEP-i për rrjetet ose shërbimet e komunikimeve elektronike dhe ato nuk duhet të publikojnë kushtet që zbatohen ndaj sipërmarrësve nga akte të tjera ligjore në fuqi.

### **Neni 13**

#### **Lista minimale e të drejtave që rrjedhin nga autorizimi i përgjithshëm**

1. Sipërmarrësit, që i nënshtrohen regjimit të autorizimit të përgjithshëm, kanë të drejtë:
  - a) të ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike, pas regjistrimit në AKEP;
  - b) të aplikojnë për të drejtat e nevojshme për instalimin e faciliteteve në përputhje me nenin 57 të ligjit 54/2024;
  - c) të përdorin spektrin e radio frekuencave në lidhje me shërbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike sipas përcaktimeve në nenet 28, 31, 66 dhe 75, të Ligjit 54/2024;
  - d) të aplikojnë për të drejtat e përdorimit të nevojshme për burimet e numeracionit në përputhje me nenet 131 dhe 132, të Ligjit 54/2024;
2. Kur një sipërmarrës është autorizuar sipas këtij ligji, për të ofruar rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike për publikun, atëherë autorizimi i përgjithshëm i jep të drejtë:
  - a) të negociojë për interkoneksion dhe, kur është e zbatueshme, për të marrë akses nga sipërmarrësit e tjerë të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve të disponueshme për publikun në përputhje me këtë ligj;
  - b) të marrë pjesë në përcaktimin si ofrues i shërbimit universal për shërbime të veçanta të shërbimit universal ose për të mbuluar pjesë të caktuara të territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e Ligjit 54/2024.

### **Neni 14**

#### **Kundërvajtjet administrative**

Mosrespektimi i kërkesave ligjore dhe nënligjore në fuqi lidhur me autorizimin e përgjithshëm, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas përcaktimeve të nenit 184, të ligjit nr. 54/2024.

## **KREU III**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 15**

#### **Dispozita kalimtare**

1. Brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, çdo sipërmarrës ekzistues i regjistruar në regjistrin aktual të Autorizimit të Përgjithshëm, duhet të njoftojë në AKEP sipas formularit të ri të njoftimit dhe do të pajiset me Certifikatë Konfirmimi në zbatim të ligjit nr. 54/2024, pasi të ketë përmbushur çdo detyrim financiar kundrejt AKEP.

**Neni 16**  
**Shfuqizimi**

Rregullorja nr. 47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, shfuqizohet.

**Neni 17**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Këshilli Drejtues i AKEP.

## ANEKS 1

### LISTA E PËRDITËSUAR E RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE QË MUND TË NJOFTOHEN PËR T'U OFRUAR NGA SIPËRMARRËSIT

#### I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Sipërmarrësi i regjistruar nga AKEP, ka detyrimin ligjor të ofrojë vetëm ato rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike të regjistruara në bazën e të dhënave elektronike dhe të përcaktuara në Çertifikatën e Konfirmimit, në përputhje të plotë me kushtet e përgjithshme dhe/ose të veçanta të vendosura nga AKEP.
2. Rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike të cilat mund të ofrohen nga sipërmarrësit përcaktohen në këtë aneks.
3. Rrjetet ose shërbimet e komunikimeve elektronike të papërcaktuara në këtë rregullore ose akte të veçanta rregullatore të AKEP, si dhe kushtet e veçanta të ofrimit të tyre, në varësi të kërkesës dhe zhvillimeve të tregut, përcaktohen nga AKEP me akte individuale ose të përgjithshme rregullatore dhe bëhen pjesë e Autorizimit të Përgjithshëm.
4. Ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të panjoftuara paraprakisht në AKEP sipas kësaj Rregullore, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas pikës 1, germa a, “i”, të nenit 184 të ligjit nr. 54/2024.

#### II. RRJETET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE:

1. Rrjete të komunikimeve elektronike, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, klasifikohen:
  - a) Rrjet fiks tokësor i komunikimeve publike;
  - b) Rrjet i lëvizshëm tokësor i komunikimeve publike;
  - c) Rrjet satelitor i komunikimeve publike
2. Rrjete të komunikimeve elektronike, për ofrimin e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, sipas këtij klasifikimi:
  - a) Rrjet për transmetimet audio dhe/ose audiovizive që kërkon përdorimin e frekuencave që administrohen nga AKEP sipas ligjit nr. 54/2024;
  - b) Rrjet për transmetimet audio dhe/ose audiovizive që nuk kërkon përdorimin e frekuencave:
    - i) rrjet i transmetimit kabllor;
    - ii) rrjet i transmetimit satelitor.
3. Rrjete të tjera

### **III. SHËRBIMET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE:**

1. Shërbim për ofrimin e transmetimit të të dhënave, të disponueshme për publikun.
2. Shërbim për ofrimin e aksesit në Internet, fik ose i lëvizshëm i disponueshëm për publikun.
3. Shërbime të komunikimeve ndërpersonale bazuar në numra, të ofruara në rrjetin fik, duke përfshirë ato nomadë/ të pavarura nga vendndodhja.
4. Shërbime të komunikimeve ndërpersonale bazuar në numra, të ofruara në rrjetin e lëvizshëm.
5. Shërbim me vlerë të shtuar.
6. Shërbim për dhënien e linjave me qira për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun.
7. Shërbimet Makinë-me-Makinë (M2M) të cilat përfshijnë një transferim automatik të të dhënave dhe informacionit midis pajisjeve ose aplikacioneve të bazuara në softëare, me ndërveprim të kufizuar ose jo njerëzor.
8. Shërbime të tjera

## ANEKS 2

# FORMULARI I NJOFTIMIT ONLINE PËR REGJISTRIMIN E OFRIMIT TË RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

## FORMULAR NJOFTIMI



TABELA 1- QËLLIMI I NJOFTIMIT

Subjekti i njoftimit	
1.1 Njoftim për fillimin e ofrimit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve	<input type="checkbox"/>
1.2 Njoftim për ndryshime <sup>1</sup> në lidhje me rrjetet/shërbimet e regjistruara në AKEP	<input type="checkbox"/>
1.3 Ndryshime në lidhje me të dhënat e identifikimit të sipërmarrësit (të dhëna të kontaktit, personit të kontaktit etj) <sup>2</sup>	<input type="checkbox"/>
1.4 Ndryshime në lidhje me datën e parashikuar të fillimit të rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike <sup>3</sup>	<input type="checkbox"/>
1.5 Njoftim për cregjistrim <sup>4</sup>	<input type="checkbox"/>

TABELA 2- TË DHËNAT E IDENTIFIKIMIT

**Të dhënat e nevojshme për të identifikuar aplikantin**

<sup>1</sup> Nënkupton ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të reja, zgjerimi ose reduktimi i zonës gjeografike të ofrimit, ndërprerja e ofrimit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve etj. Nëse zgjidhet ky opsion, do të plotësohen pikat 2.1 dhe 2.2 të tabelës 2 dhe tabela 4.

<sup>2</sup> Nëse zgjidhet ky opsion, do të plotësohen sipas rastit tabelat 2 dhe/ose 3.

<sup>3</sup> Nëse zgjidhet ky opsion, do të plotësohen pikat 2.1 dhe 2.2 të tabelës 2 dhe tabela 4

<sup>4</sup> Nëse zgjidhet ky opsion, do të plotësohen pikat 2.1 dhe 2.2 të tabelës 2 dhe data e ndërprerjes së aktivitetit do të plotësohet në seksionin ngjitur.

2.1 Emri i sipërmarrësit	
2.2 a) NIPT/ NUIS	
b) Forma e Regjistrimit (sh.a; shpk, person fizik etj)	
2.3 Adresa e zyrës qendrore të sipërmarrësit dhe adresa e degës dytësore nëse disponon	
2.4 Faqja e internetit, e dedikuar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike	
2.5 E-mail	
2.6 Numri i telefonit	
2.7 Fax	

### TABELA 3- PERSONI I KONTAKTIT DHE TË DHËNAT E TIJ

<b>Personi i kontaktit</b>	
3.1 Emri dhe mbiemri i personit të kontaktit, i autorizuar nga sipërmarrësi për të paraqitur njoftimin ose dokumenta të tjera në emër të tij. Lutem bashkëngjitni këtij formulari autorizimin e sipërmarrësit.	
3.2 Numri i telefonit	
3.3 E-mail	
3.4 Adresa e plotë <sup>5</sup>	
<b>Personi alternativ i kontaktit</b>	
3.5 Emri dhe mbiemri	
3.6 Numri i telefonit	
3.7 E-mail	
3.8 Adresa e plotë <sup>6</sup>	

<sup>5</sup> Adresa e korrespondencës me AKEP, opsionale, duhet të plotësohet vetëm nëse është e ndryshme nga ajo e deklaruar në pikën 2.3

<sup>6</sup> Adresa e korrespondencës me AKEP, opsionale, duhet të plotësohet vetëm nëse është e ndryshme nga ajo e deklaruar në pikën 2.3

**TABELA 4- PËRSHKRIM I SHKURTËR I RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE**

Llojet e rrjeteve/ shërbimeve të komunikimeve elektronike	Përshkrim i shkurtër i rrjetit/ shërbimit <sup>7</sup>	Zona gjeografike e ofrimit të rrjetit dhe/ose shërbimit <sup>8</sup>  <input type="checkbox"/> Kombëtar <input type="checkbox"/> Qark <input type="checkbox"/> Bashki <input type="checkbox"/> Njësi administrative	Shërbim me shumicë <sup>9</sup>	Data e parashikuar e fillimit të rrjeteve/shërbimeve	Data e ndërprerjes së rrjeteve/shër bimeve
<b>Përshkrim i rrjetit</b>					
<input type="checkbox"/> Përcjellës metalik					
<input type="checkbox"/> Kabllo koaksial					
<input type="checkbox"/> Fibër optike					
<input type="checkbox"/> Sistem transporti të rrymës elektrike (PCL) <sup>10</sup>					
<input type="checkbox"/> Kabllo nënujore (submarine)					
<input type="checkbox"/> Spektër radio i licencuar (lidhje					

<sup>7</sup> Nëse qëllimi është rishitja e shërbimeve, do të zgjidhet opsioni i dedikuar. Aktiviteti i rishitjes përfshin blerjen nga sipërmarrësi të shërbimeve të komunikimeve elektronike me qëllim shitjen e mëvoshme tek palët e treta, duke përfshirë përdoruesit fundor.

<sup>8</sup> Sipërmarrësi duhet të plotësojë në këtë kolonë zonën gjeografike të ofrimit të rrjetit/shërbimit, duke përcaktuar njësinë administrative, bashkinë apo qarkun përkatës.

<sup>9</sup> Kjo do të plotësohet nëse shërbimi është menduar të ofrohet vetëm në nivelin e tregut me shumicë, duke përjashtuar mundësinë e aktivizimit në nivelin e tregut me pakicë.

<sup>10</sup> Nënkupton që i njëjti kabull që dërgon rrymën elektrike, përdoret edhe për transmetim të të dhënave.

Llojet e rrjeteve/ shërbimeve të komunikimeve elektronike	Përshkrim i shkurtër i rrjetit/ shërbimit <sup>7</sup>	Zona gjeografike e ofrimit të rrjetit dhe/ose shërbimit <sup>8</sup>  <input type="checkbox"/> Kombëtar <input type="checkbox"/> Qark <input type="checkbox"/> Bashki <input type="checkbox"/> Njësi administrative	Shërbim me shumicë <sup>9</sup>	Data e parashikuar e fillimit të rrjeteve/shërbimeve	Data e ndërprerjes së rrjeteve/shër bimeve
fikse mikrovalore) <sup>11</sup>					
<input type="checkbox"/> Spektër radio i palicencuar (ËLAN 2.4/5.8 GHz) <sup>12</sup>					
<input type="checkbox"/> Rrjet celular (2G, 3G, 4G, 5G)					
<input type="checkbox"/> Rrjete të tjera të lëvizshme (psh TETRAPOL rrjete të emergjenceve)					
<input type="checkbox"/> Rrjete satelitore					
<input type="checkbox"/> Rrjete që mundësojnë transmetime audio/audiovizive					
<input type="checkbox"/> Lloje të tjera rrjetesh					

**Përshkrim i shërbimit**

<sup>11</sup> Sipërmarrësi, në rastin e ofrimit të rrjetit nëpërmjet lidhjeve mikrovalore, aplikon në AKEP, sipas regjimit të Autorizimit Individual.

<sup>12</sup> Sipërmarrësi, në rastin e ofrimit të rrjetit me frekuenca të 2.4/5.8 GHz, të cilat përdoren pa Autorizim Individual, duhet të njoftojë në AKEP formularin e regjistrimit për përdorimin e këtyre frekuencave përpara përdorimit të tyre.

Llojet e rrjeteve/ shërbimeve të komunikimeve elektronike	Përshkrim i shkurtër i rrjetit/ shërbimit <sup>7</sup>	Zona gjeografike e ofrimit të rrjetit dhe/ose shërbimit <sup>8</sup>  <input type="checkbox"/> Kombëtar <input type="checkbox"/> Qark <input type="checkbox"/> Bashki <input type="checkbox"/> Njësi administrative	Shërbim me shumicë <sup>9</sup>	Data e parashikuar e fillimit të rrjeteve/shërbimeve	Data e ndërprerjes së rrjeteve/shër bimeve
<input type="checkbox"/> Akses në Internet në rrjet fiks (Fixed IAS)	<input type="checkbox"/> Rishitje .....		<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> Akses në Internet në rrjet të lëvizshëm (Mobile IAS)	<input type="checkbox"/> Rishitje .....		<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> Komunikime ndërpersonale bazuar në numra në rrjet fiks (duke përfshirë ato nomadë/ të pavarura nga vendndodhja) (Fixed NB-ICS)	<input type="checkbox"/> Rishitje .....		<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> Komunikime ndërpersonale bazuar në numra në rrjet të lëvizshëm (Mobile NB-ICS)	<input type="checkbox"/> Rishitje .....		<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> Transmetim të dhënash	<input type="checkbox"/> Rishitje .....		<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> Linja me qira	<input type="checkbox"/> Rishitje		<input type="checkbox"/>		

Llojet e rrjeteve/ shërbimeve të komunikimeve elektronike	Përshkrim i shkurtër i rrjetit/ shërbimit <sup>7</sup>	Zona gjeografike e ofrimit të rrjetit dhe/ose shërbimit <sup>8</sup>  <input type="checkbox"/> Kombëtar <input type="checkbox"/> Qark <input type="checkbox"/> Bashki <input type="checkbox"/> Njësi administrative	Shërbim me shumicë <sup>9</sup>	Data e parashikuar e fillimit të rrjeteve/shërbimeve	Data e ndërprerjes së rrjeteve/shër bimeve
	.....				
<input type="checkbox"/> Rishitja e programeve televizive	<input type="checkbox"/> .....		<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> Transport i trafikut të telefonisë midis operatorëve	<input type="checkbox"/> Rishitje .....		<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> M2M <sup>13</sup>	<input type="checkbox"/> Rishitje .....		<input type="checkbox"/>		
<input type="checkbox"/> Lloje të tjerash shërbimesh	<input type="checkbox"/> Ritransmetimi i shërbimeve të programave mediatike audiovizuale lineare  <input type="checkbox"/> Rishitje ..... <input type="checkbox"/> Lloje të tjera Specifiko _____ <input type="checkbox"/> Rishitje.....		<input type="checkbox"/>		

<sup>13</sup> Makinë-me-Makinë (M2M)- një shërbim që përfshin një transferim automatik të të dhënave dhe informacionit midis pajisjeve ose aplikacioneve të bazuara në softuer, me ndërveprim të kufizuar ose jo njerëzor.

## TABELA 5- DOKUMENTACIONI SHOQËRUES I FORMULARIT TË NJOFTIMIT

Aplikuesi, bashkëngjit dokumentacionin e mëposhtëm, i cili është pjesë e njoftimit.

1. Kopje të ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe kopje të ekstraktit historik. Forma ligjore për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete/shërbime të komunikimeve elektronike duhet të jetë person juridik, duke përjashtuar vetëm ofruesit e shërbimit me vlerë të shtuar, ofruesit e rrjeteve audio/audiovizive si dhe sipërmarrësit me zonë ofrimi shërbimi deri një 1 bashki, të cilët mund të jenë edhe persona fizikë.
2. Kopje të letërnjoftimit (kartës së identitetit) ID të administratorit/përfaqësuesit ligjor të personit juridik/fizik.
3. Përshkrimin teknik për rrjetet dhe/ose shërbimet që kërkon të ofrojë, listën e pajisjeve kryesore të rrjetit dhe tipologjinë e rrjetit, hartuar nga një inxhinier i diplomuar në drejtimin elektronik/telekomunikacion ose ekuivalente me to (vërtetuar me diplomën përkatëse të arsimit të lartë), duke përfshirë përshkrim teknik të detajuar mbi lidhjet e interkoneksionit kombëtar dhe ndërkombëtar (si teknologjia e përdorur, pika e lidhjes, kapaciteti i transmetimit dhe i kontraktuar etj)
4. Të dhëna për sistemin e billingut.
5. Kontratën tip të pajtimit (termat dhe kushtet e përgjithshme).
6. Një marrëveshje interkoneksioni/ aksesit paraprake (nëse aplikohet për shërbimin/rrjetin e ofruar).
7. Formularin e aplikimit për caktimin e Kodit NSPC (sipas rastit).
8. Formularin e aplikimit për caktimin e Kodit ISPC (sipas rastit).
9. Informacion për sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve (pajisjet e përdorura, politikat e sigurisë së rrjetit, etj) si dhe një plan veprimi për sigurinë e rrjeteve të komunikimeve në rast emergjencash apo fatkeqësish natyrore).
10. Strukturën organizative dhe stafin teknik të kualifikuar (CV, kopje diplome, kualifikimet profesionale, sigurime shoqërore dhe shëndetësore), të paktën për një (1) inxhinier dhe një (1) teknik, në rastin e zonës minimale të shërbimit.
11. Dokumentacion mbështetës për vërtetimin e kapaciteteve financiare përfshin sipas rastit: pasqyra financiare dhe/ose deklarata bankare, mbi disponueshmërinë e burimeve financiare në vlerën minimale prej 1.000,000 Lekë.

Data e aplikimit: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi dhe vula: \_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

## DEKLARATË<sup>14</sup>

Në emër të personit ose kompanisë njoftuese, deklaroj se informacioni i dhënë nga unë është i saktë dhe i plotë në të gjitha aspektet.

Unë deklaroj se zotëroj kapacitetet teknike, ligjore dhe financiare të nevojshme.

Unë jam dakord që adresa dhe faqja ëeb e kompanisë të publikohet në Regjistrin e Ofruesve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike.

Emri Mbiemri i nënshkruesit:

---

Pozicioni:

---

---

Nënshkrimi/ Vula e Shoqërisë:

---

Data: (dita/muaji/viti)

---

<sup>14</sup> Njoftimi duhet të nënshkruhet: a) në rastin e personit fizik, nga vet ai ose nga person i autorizuar me akt noterial (vërtetim nënshkrimi ose prokurë), b) në rastin e personave juridik nga administratori, ose çdo person i autorizuar nga ai.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

---

**CERTIFIKATË**

**E**

**KONFIRMIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_/datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

**SIPËRMARRËSI “XXXXXXXXXX”**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare konfirmon se sipërmarrësi “XXXXXXXXXX” me adresë: XXXXXXXX, ka paraqitur Njoftimin e Regjistrimit sipas (baza ligjore) \_\_\_\_\_ dhe është regjistruar në Regjistrin e Sipërmarrësve për ofrimin e rrjeteve dhe të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

**K R Y E T A R I**

(nënshkrimi & vula e autoritetit)

---

Rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike të njoftuara në AKEP nga sipërmarrësi  
“XXXXXXXX”

**A.** Rrjete publike të komunikimeve elektronike:

a) .....  
.....

**B.** Shërbime publike të komunikimeve elektronike:

a) .....  
.....

**C.** Zona e gjeografike:

a) .....  
.....

Sipërmarrësi i regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të mësipërme, i cili operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, është i detyruar të zbatojë termat dhe kushtet e parashtruara në Aneksin 5 të Rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm.

Sipërmarrësit ka të drejtë të instalojë facilitetet, të negociojë për interkoneksion ose të marrë akses e interkoneksion, me qëllim lehtësimin e ushtrimit të këtyre të drejtave gjatë aplikimit pranë niveleve të tjera të qeverisjes ose tek sipërmarrës të tjerë.<sup>15</sup>

Në faqen zyrtare të ëeb, AKEP, publikon një regjistër të përditësuar të të gjithë sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke përfshirë informacionin mbi llojet e rrjeteve dhe shërbimeve që ata ofrojnë.

**Nr. X-X / datë XX.XX.20XX**



---

<sup>15</sup> Ky paragraph do të shtohet vetëm për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike

## ANEKSI 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**REGJISTRI I SIPËRMARRËSVE QË OFROJNË RRJETE/SHËRBIME PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE  
SIPAS REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM PËRDITËSUAR DERI NË DATËN \_\_\_\_\_**

Nr.	Emri i sipërmarrësit	Numri i Çertifikatës dhe data	Rrjetet	Shërbimet	Zona gjeografike e rrjetit / shërbimeve	NIPT-i	Adresa e sipërmarrësit	Faqja ëeb

## ANEKSI 5

### KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR OFRIMIN E RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Çdo sipërmarrës i autorizuar sipas ligjit nr. 54/2024, për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, është i detyruar t'i zbatojë tërësisht apo pjesërisht, kushtet e përgjithshme dhe kushtet specifike që vendosen nga AKEP në regjimin e autorizimit të përgjithshëm në varësi të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike që do të ofrojë sipas njoftimit të regjistrimit.

### KUSHTET E PËRGJITHSHME

#### 1. Kryerja e pagesave

Sipërmarrësit të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm janë të detyruar të kryejnë në AKEP pagesat e përcaktuara në ligjin nr. 54/2024, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe në aktet rregullatore të AKEP.

Pagesat që kryhen në AKEP janë:

- a) pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve në nenin 20 të ligjit. Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit, janë të detyruar të paguajnë një pagesë vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike nga AKEP-i. Kjo pagesë nuk duhet të jetë më shumë se 0,5 % e së ardhurës vjetore të vitit kalendarik të mëparshëm dhe duhet të realizohet brenda datës 30 prill të çdo viti. Procedura dhe mënyra e llogaritjes përcaktohen në rregulloren e AKEP për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike.
- b) pagesa për përdorimin e frekuencave sipas përcaktimeve në nenin 21 të këtij ligji dhe VKM për miratimin e pagesave që kryhen në autoritetin e komunikimeve elektronike dhe postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike, vendimit të Këshillit të Ministrave;
- c) pagesa për caktimin dhe përdorimin e numrave, të serive numerike, përfshirë caktimin e emrave të domain-it, sipas sipas përcaktimeve në nenin 22 të këtij ligji.
- d) Pagesa për tarifën për të drejtat e përdorimit të spektrit të frekuencave (tarifa e shërbimit të radiokomunikacionit). Në bazë të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe AKEP, Nr. 28, datë 06.10.2008, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit” i ndryshuar, AKEP është agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në Buxhetin e Shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit.
- e) Pagesa për financimin e shërbimit universal, kur është e aplikueshme, sipas përcaktimeve në nenin 128 të ligjit. AKEP-i përcakton kuotën e financimit, e cila nuk duhet të jetë më e

lartë se 1% e totalit të të ardhurave të siguruar nga rrjetet e komunikimeve elektronike publike dhe ofrimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

- f) Pagesa për portabilitetin e numrit sipas përcaktimeve të pikës 9, nenit 145, të ligjit nr. 54/2024 dhe Rregullores “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, operatorët janë të detyruar të kryejnë pagesën e llogaritur nga AKEP, për mbulimin e kostove financiare të ofrimit të shërbimit të operatorit të CRDB si dhe hostimit të platformës
- g) Tarifat/pagesat administrative të përcaktuara me vendim të Këshillit Drejtues (VKD) nr. 13 datë 27.08.2025, në kuadër të implementimit të regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

Moskryerja e plotë dhe në afat e këtyre pagesave, përbën kundërvajtje administrative dhe është e dënueshme në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 184 të ligjit nr. 54/2024.

Moskryerja e plotë dhe në afat e pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave dhe numeracionin përveçse është e dënueshme me gjobë, çon edhe në revokimin nga AKEP të autorizimeve individuale për dhënien e të drejtës së përdorimit të tyre.

Sipërmarrësit, të cilët sipas ligjit nr. 54/2024 dhe Rregullores së AKEP “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” janë sanksionuar me gjobë nga inspektorët për kundërvajtje administrative, në përputhje me përcaktimet ligjore janë të detyruar të ekzekutojnë pagesën e gjobës brenda afatit të përcaktuar në nenin 184 të ligjit nr. 54/2024. Gjoha sipas ligjit nr. 10 279, datë 20. 05. 2010 “Për kundërvajtjet administrative”, është titull ekzekutiv.

## **2. Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësia**

Sipërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike që administrojnë të dhënat vetjake dhe personale të përdoruesve/pajtimtarëve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike që ata ofrojnë, kanë detyrimin ligjor të mbrojtjes së këtyre të dhënave dhe privatësisë në përputhje me përcaktimet e kreu XIX të ligjit nr. 54/2024, ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në fuqi, rregullores së AKEP për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, rregullores së AKEP mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Rregullat e përcaktuara në rregulloren “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë sipërmarrësit që disponojnë rrjete të komunikimeve elektronike dhe/ose që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike publike.

Sipërmarrësit duhet të marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme ndaj sistemeve të komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave, për të mbrojtur sekretin e komunikimeve elektronike dhe të të dhënave personale nga aksesit i paautorizuar i sistemeve të komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave.

Sipërmarrësi, të autorizuarit dhe punonjësit e tij detyrohen të ruajnë e të mbrojnë të dhënat dhe fshehtësinë e komunikimeve, që kryhen nëpërmjet rrjetit e shërbimeve të tij, gjatë gjithë periudhës së kryerjes së veprimtarisë, por dhe pas përfundimit të saj.

Është e ndaluar për sipërmarrësit marrja, regjistrimi, publikimi, ruajtja, përgjimi ose ndonjë lloj tjetër mbikëqyrjeje e komunikimeve, si dhe të dhënave të lidhura me trafikun pa miratimin paraprak të përdoruesit ose të personave të tjerë në komunikim, të ndryshëm nga përdoruesi, përveç rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Në mënyrë të veçantë, duhet të merren masa për të parandaluar dhe minimizuar ndikimin e aksidenteve të sigurisë mbi përdoruesit e rrjeteve të ndërlydhura.

Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në zbatim të ligjit nr. 54/2024, dhe rregullores së AKEP “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, të marrin masa lidhur me:

- a) Konfidencialitetin e komunikimit;
- b) Ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për qëllime të ndjekjes penale dhe të sigurisë kombëtare
- c) Faturimin e detajuar për shërbimet telefonike të vlefshme për publikun
- d) Identifikimin e linjës thirrëse dhe të thirrur;
- e) Të dhënat për vendndodhjen;
- f) Ridrejtimin automatik të thirrjeve;
- g) Komunikimet pa kërkesë;
- h) Të dhënat e përdoruesit fundor.
- i) Numërorin telefonik
- j) Përgjimin e ligjshëm të komunikimeve

### **3. Përbushja e detyrimeve të njoftuara në AKEP me Formularin e Njoftimit, përfshirë detyrimet e marra përsipër me vetëdeklarim.**

Njoftimi i regjistrimit për ofrimin e rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike aplikuesi shoqërohet me informacionin e përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 54/2024 dhe këtë rregullore.

Paraqitja e informacionit mbi:

- a) emrin, adresën e selisë kryesore të sipërmarrësit dhe sipas rastit, çdo adresë dytësore;
- b) të dhënat e regjistrimit ligjor të sipërmarrësit, statusin ligjor, formën dhe numrin e regjistrimit.
- c) personin e kontaktit dhe të dhënat e kontaktit të sipërmarrësit;
- d) adresën e faqes ëeb të sipërmarrësit, që lidhet me ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- e) përshkrimin e shkurtër të rrjetit ose shërbimit të komunikimeve elektronike që do të ofrojë, sipas përcaktimeve të parashikuara në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje;
- f) datën kur është parashikuar fillimi i ofrimit, ndryshimi ose përfundimi i shërbimit;

shtrirjen gjeografike të rrjetit dhe shërbimeve që do të ofrohen, e cila do të jetë minimumi një njësi administrative.

- g) deklaratën për datën, brenda së cilës sipërmarrësi përfundon ndërtimin e rrjetit ose fillon ofrimin e shërbimeve të tij.
- h) dokumentacion mbështetës për vërtetimin e kapaciteteve financiare përfshin sipas rastit: pasqyra financiare dhe/ose deklarata bankare, mbi disponueshmërinë e burimeve financiare në vlerën minimale prej 1,000,000 lekë.
- i) sipërmarrësit e rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të raportojnë në AKEP çdo 6 muaj të dhënat mbi shtrirjen e rrjetit të tyre në zbatim të rregullores Për Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrimit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.
- j) si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar në Formularin e Njoftimit sipas Aneksit 2, përbën kërkesë ligjore dhe është i detyrueshëm për t'u zbatuar.

Kur ofrimi i rrjetit dhe shërbimit të komunikimeve elektronike të parashikuara mbështetet në përdorimin e frekuencave sipas Planit Kombëtar të Frekuencave (PKF) dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave (PPF), aplikuesi është i detyruar të pajisjet me lejen e përdorimit të tyre nga AKEP.

Në këto raste sipërmarrësi është i detyruar që njëkohësisht me procedurën e regjistrimit të njoftimit sipas kësaj rregullore, të zbatojë edhe procedurën për dhënien nga AKEP të së drejtës për përdorimin e frekuencave nëpërmjet autorizimit individual. Procedura për t'u pajisur me autorizim individual për përdorimin e frekuencave përcaktohet në rregulloren “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”.

Në rastet kur ofrimi i rrjetit dhe shërbimit të komunikimeve elektronike të parashikuar ka nevojë për përdorimin e numrave dhe serive numerike, atëherë aplikuesi është i detyruar që njëkohësisht me procedurën e regjistrimit të njoftimit sipas kësaj rregullore, të zbatojë edhe procedurën për dhënien nga AKEP të së drejtës për përdorimin e numrave. Procedura për t'u pajisur me autorizim për përdorimin e numrave dhe serive numerike përcaktohen në Rregulloren “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”.

Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike janë të detyruar që t'i japin AKEP, me kërkesën e tij çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur detyrimet funksionale të AKEP, sipas ligjit nr. 54/2024.

AKEP, bazuar në rregulloren “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, përcakton informacionin të cilin sipërmarrësit janë të detyruar ta dërgojnë në AKEP sipas formës, afatit dhe procedurës së kërkuar për qëllime statistikore të kryerjes së analizës së tregjeve, monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë së tregut, etj.

Informacioni mbi mënyrën e publikimit të tarifave dhe shërbimeve dërgohet nga sipërmarrësit në AKEP sipas përcaktimeve të parashikuara në Rregullores “Mbi publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.

Informacioni me të dhënat mbi cilësinë e ofrimit të rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për përdoruesit, paraqitet dhe dërgohet nga sipërmarrësit në AKEP sipas afateve, procedurës dhe formës së përcaktuar në Rregulloren “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”.

Informacioni mbi të dhënat e rrjeteve të komunikimeve elektronike paraqitet dhe dërgohet në AKEP në përputhje me procedurën dhe formën e përcaktuar në Rregulloren “Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrimit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Informacioni mbi sigurinë e rrjeteve dhe incidentet e sigurisë dërgohet nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Sipërmarrësit, të cilët ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike, janë të detyruar t’i paraqesin ministrit, me kërkesën e tij, të gjithë informacionin e nevojshëm për të përmbushur detyrat funksionale të ministrit, sipas ligjit nr. 54/2024.

#### **4. Ruajtja dhe administrimi i të dhënave për qëllime të ndjekjes penale dhe të sigurisë kombëtare**

Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, detyrohen që t’ju venë pa vonesë në dispozicion, edhe në formë elektronike, autoriteteve që përcakton Kodi i Procedurës Penale, në bazë të kërkesës së tyre, informacionin me skedarët e të dhënave për pajtimtarët, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 160 të ligjit nr. 54/2024.

Për qëllime të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, luftimit të krimeve të rënda dhe parandalimit të kërcënimeve serioze ndaj sigurisë publike, sipërmarrësit duhet të ruajnë të dhënat e trafikut të komunikimeve elektronike.

Skedarët e të dhënave, me qëllim mundësimin e hetimit, zbulimin dhe procedimin penal, në përputhje me procedurën penale dhe për qëllime të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, në përputhje me ligjet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, ruhen dhe administrohen nga sipërmarrësit nga sipërmarrësit për një afat maksimal dyvjeçar, në përputhje me nenin 160 të ligjit nr. 54/2024. Këta skedarë duhet të përmbajnë të dhëna që mundësojnë:

- a) identifikimin e pajtimtarëve, duke siguruar marrjen dhe regjistrimin e identitetit të plotë të tyre;
- b) identifikimin e pajisjes fundore të përdorur gjatë komunikimeve;
- c) përcaktimin e vendndodhjes, datës, kohës, kohëzgjatjes së komunikimit dhe numrit të thirrur dhe thirrës, përfshirë të dhënat për thirrjet pa përgjigje.

4. Në rastin e komunikimeve në internet, skedari duhet të përmbajë:

- a) të dhëna të nevojshme për ndjekjen dhe identifikimin e burimit të komunikimit:
  - i. identitetin e pajtimtarit të caktuar;

- ii. identitetin e pajtimtarit dhe numrin e telefonit të caktuar për komunikimet, që hyjnë në rrjetin publik telefonik;
  - iii. emrin dhe adresën e pajtimtarit ose përdoruesit të regjistruar, të cilit i është caktuar një adresë IP, identitetin e përdoruesit ose numër telefoni i caktuar gjatë kohës së komunikimit;
- b) të dhëna të nevojshme për identifikimin e destinacionit të komunikimit:
- i. në rastin e telefonisë në internet, identitetin e përdoruesit ose numrin e telefonit të numrit të thirrur;
  - ii. në rastin e postës elektronike ose telefonisë në internet, emrin dhe adresën e pajtimtarit ose përdoruesit të regjistruar dhe identitetin e përdoruesit të marrësit të synuar të komunikimit;
- c) të dhëna të nevojshme për identifikimin e datës, kohës dhe kohëzgjatjes së komunikimit:
- i. datën dhe orën e lidhjes dhe shkëputjes të shërbimit të aksesit në internet, sipas orës lokale;
  - ii. adresën IP, duke përcaktuar nëse është dinamike apo statike, të caktuar nga ofruesi i shërbimit internet;
  - iii. identitetin e pajtimtarit ose përdoruesit të regjistruar të shërbimit të aksesit në internet.

Të dhënat në këta skedarë ruhen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këta skedarë u vihen në dispozicion pa vonesë edhe në formë elektronike, në bazë të kërkesës së tyre, autoriteteve që përcakton Kodi i Procedurës Penale, gjykatës, prokurorisë dhe çdo organi publik që ligji i posaçëm i jep këtë të drejtë për të parandaluar, hetuar, zbuluar ose ndjekur penalisht vepra penale ose ekzekutimi të dënimeve penale, duke përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike, mbrojtjes ose sigurisë kombëtare ose çdo institucioni tjetër, të cilit me ligj i jepet e drejta për të ushtruar funksione, detyra ose kompetenca publike, bazuar në legjislacionin në fuqi për një ose disa nga këto qëllime, bazuar në kërkesën e tyre.

Operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike janë të detyruar të shkatërrojnë të dhënat e ruajtura në përfundim të afatit të ruajtjes, kur nuk është parashikuar ndryshe në legjislacionin në fuqi.

## **5. Lejimi i përgjimit nga autoritetet kombëtare kompetente**

Sipërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike kanë detyrimin e zbatimit të kërkesave dhe kushteve lidhur me përgjimin e ligjshëm të komunikimeve elektronike, të përcaktuara në nenin 168 të ligjit 54/2024, ligjin “Për përgjimin e telekomunikimeve”, në fuqi dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **6. Kushtet e përdorimit nga autoritetet publike të komunikimeve për publikun e gjerë, për paralajmërimin e publikut nga rreziqe të afërta dhe për masat e shmangies së katastrofave të mëdha**

Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike duhet t’i mundësojnë autoriteteve publike përgjegjëse që të përdorin rrjetet e komunikimeve elektronike për të paralajmëruar publikun për rreziqe që po ndodhin ose janë shumë afër (tërmet, përmytje, zjarre, shpërthime, sulme kimike etj.), duke dërguar njoftime urgjente për evakuim, shmangie zonash, masa mbrojtëse, mbyllje rrugësh, ndërprerje shërbimesh kritike etj.

## **7. Kushtet e përdorimit gjatë fatkeqësive të mëdha ose emergjencave kombëtare për të siguruar komunikimin ndërmjet shërbimeve të emergjencave dhe autoriteteve**

Sipërmarrësit detyrohen që, me rrjetet dhe shërbimet, të përballojnë nevojat e shtetit në situata të jashtëzakonshme dhe kur e kërkojnë interesat e mbrojtjes kombëtare e sigurisë së rendit publik.

Në kuptim të ligjit 54/2024, me situatë të jashtëzakonshme kuptojmë dëmtimet e rënda të rrjetit, fatkeqësitë natyrore, gjendjen e emergjencës civile ose gjendjen e luftës.

Sipërmarrësit, që ofrojnë akses në rrjetet e komunikimeve elektronike publike dhe shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun, hartojnë dhe paraqesin në AKEP një plan për të siguruar integritetin e rrjetit të komunikimeve publike dhe akses në shërbimet e komunikimeve publike, të zbatueshëm në situatë të jashtëzakonshme.

Plani që paraqesin sipërmarrësit, duhet të sigurojë akses të pandërprerë dhe përdorimin e numrave të emergjencës dhe detyrojnë sipërmarrësit të zbatojnë masat emergjente përgjatë gjithë kohëzgjatjes së situatës të jashtëzakonshme.

Plani hartohet në përputhje me vendimin e këshillit të ministrave (VKM), për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme.

Sipërmarrësit detyrohen të bashkëveprojnë ndërmjet tyre dhe me organizatat qeveritare, ndërqeveritare dhe jofitimprurëse për përdorimin e burimeve të komunikimeve elektronike, për lehtësimin dhe përballimin e rasteve të veçanta, duke:

- a) vendosur pajisje të komunikimit tokësor dhe satelitor për parandalimin, mbikëqyrjen dhe sigurimin e parandalimit të dëmeve natyrore, fatkeqësive në përgjithësi e atyre shëndetësore në veçanti;
- b) shpërndarë njoftime për shkatërrimet natyrore, fatkeqësitë shëndetësore ndërmjet organizmave të lidhur me to dhe përhapjen e të dhënave në publik, veçanërisht në komunitetet që rrezikohen më tepër;
- c) vendosur dhe vënë në punë shërbimet e komunikimeve elektronike fleksibël, që përdorin organizatat humanitare.

Për lehtësimin e realizimit të masave të mësipërme, sipërmarrësit mund të lidhin marrëveshje të veçanta dhe të vendosin pagesa të veçanta ose të nënshkruajnë shtesa në marrëveshjet ekzistuese.

Ofruesit e shërbimit universal janë të detyruar të përcaktojnë paraprakisht personelin e tyre, që siguron shërbimin universal të pandërprerë në rast grevash, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të sipërmarrësit në përputhje me parashikimet e kësaj pike.

## **8. Numeracioni për shërbimet e thirrjeve të emergjencës**

Sipërmarrësit duhet të sigurojnë që të gjithë përdoruesit fundorë, përfshirë përdoruesit e telefonave publikë me pagesë të kenë akses në shërbimet e emergjencës nëpërmjet komunikimeve të

emergjencës pa pagesë dhe pa pasur nevojë të përdorin asnjë mjet pagese, duke përdorur numrin unik evropian të emergjencave “112” dhe çdo numër kombëtar të emergjencës, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Ofruesit e komunikimeve ndërpersonale të bazuara në numra duhet të sigurojnë që informacioni i vendndodhjes së palës thirrëse të vihet në dispozicion të PSAP-së (Pika e përgjigjes për sigurinë publike) më të përshtatshme, pa vonesë, pas vendosjes së komunikimit emergjent. Kjo do të përfshijë informacionin e vendndodhjes së bazuar në rrjet, dhe, kur është i disponueshëm, informacionin e vendndodhjes së palës thirrëse të gjeneruar nga aparati fundor i lëvizshëm. Ofruesit duhet të sigurojnë që krijimi dhe transmetimi i informacionit të vendndodhjes së palës thirrëse të jetë pa pagesë për përdoruesin fundor dhe PSAP-të për të gjitha komunikimet e emergjencës me numrin unik evropian të emergjencës “112”.

Ofruesit duhet të sigurojnë që përdoruesit fundorë të jenë të informuar në mënyrë të përshtatshme dhe të duhur për ekzistencën dhe përdorimin e numrit unik evropian të emergjencës “112”, si dhe funksionet e aksesueshmërisë së tij, përfshirë nëpërmjet iniciativave që synojnë veçanërisht përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara. Ky informacion do të jepet në formate të aksesueshme, duke adresuar lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara”.

## 9. Detyrimi për të ofruar akses

Sipërmarrësit me FNT ndaj të cilëve AKEP ka vendosur detyrimin për akses duhet të plotësojnë kërkesat e arsyeshme për akses, në veçanti në ato raste kur AKEP vlerëson se nga refuzimi i aksesit ose nga kushtet dhe termat e paarsyeshme, pengohet konkurrenca e qëndrueshme në tregun e pakicës, apo kur dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë.

Sipërmarrësit me FNT në mënyrë të veçantë i kërkohet:

- a) t’u ofrojë palëve të treta akses në elementë të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke përfshirë akses në elementë të rrjetit, të cilat nuk janë aktive dhe/ose akses të hapur në qarkun lokal, paralelisht, sipërmarrësit ekzistues apo të rinj që janë të autorizuar për ofrimin e rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike kanë detyrimin të negociojnë dhe të drejtohen për marrëveshje aksesit për përdorim të infrastrukturës në sipërmarrësit ofrues në një zonë të caktuar në rast se tashmë ekziston një infrastrukturë e ndërtuar dhe përmbushen kushtet teknike dhe komerciale për të ofruar bashkëpërdorim të infrastrukturës.
- b) të ofrojë shërbime të veçanta në nivel shumice, për t’u rishitur nga palët e treta;
- c) të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;
- d) të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- e) të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve;
- f) të ofrojë bashkë vendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndërtesat, tubacionet kabllore ose shtyllat, kullat;
- g) të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme ose sistemet e ngjashme informatike (*softëare*), të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme, në ofrimin e shërbimeve;
- h) të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pikë fundore – pikë fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent dhe/ose *roamingut*

- në rrjetet mobile;
- i) të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit;
  - j) të ofrojë akses në shërbimet shoqëruese.

Për ofrimin e aksesit në rrjet në nivel shumice për palët e treta, sipërmarrësit janë të detyruar të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga AKEP në Rregulloren “Për aksesin dhe interkoneksioni”.

Sipërmarrësi me FNT, ndaj të cilit është vendosur detyrim për akses, sipas nenit 98 të ligjit nr. 54/2024, duhet t’u japë sipërmarrësve të tjerë, që kërkojnë akses në rrjetin e tij, një ofertë, që ata të ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike. Oferta e aksesit duhet të paraqitet pa vonesë, por në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë nga dita e marrjes së kërkesës.

Sipërmarrësit, sigurojnë lidhjen ose aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike, në bazë të kontratës që lidhet me pajtimtarët në zbatim të legjislacionit në fuqi. Për hartimin dhe lidhjen e kontratës me pajtimtarin me qëllim realizimin e aksesit në rrjet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike që ofrojnë, sipërmarrësit janë të detyruar të zbatojnë përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 54/2024 dhe Rregulloren “Për Mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.

Të gjithë përdoruesit fundorë, që kanë akses në rrjetin e komunikimeve elektronike publike, duhet të kenë akses në shërbimet e asistencës së sipërmarrësit.

Ofruesit e shërbimit publik telefonik janë të detyruar të sigurojnë akses për çdo përdorues fundor të lidhur nëpërmjet rrjetit të tyre publik telefonik në shërbimet e postës zanore.

## **10. Masat e projektuara për të siguruar përputhjen me standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve**

Cilido sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të zbatojë standardet dhe kërkesat teknike të përcaktuara në përputhje me standardet kombëtare të përcaktuara në ligjin për standardizimin, aktet rregullatore të AKEP të nxjerra në përputhje me ligjin 54/2024. Kur standardi teknik i rrjeteve dhe pajisjeve nuk pasqyrohet në aktet ligjore, nënligjore apo rregullatore të AKEP, janë të zbatueshme standardet e miratuara dhe rekomanduara nga institucionet ndërkombëtare ITU, CEPT, ISO, IEC, dhe ETSI.

## **11. Detyrimi për transparencë ndaj ofruesve të rrjeteve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, për sigurimin e ndërlidhjes pikë fundore-pikë fundore, dhe kur është e nevojshme dhe proporcionale detyrimin për akses në informacionin që është i nevojshëm për verifikimin e saktësisë së këtij kushti.**

Transparenca dhe publikimi i informacionit nga sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe komunikime elektronike publike mbi kushtet e ofrimit të shërbimeve në tregun e pakicës për pajtimtarët dhe shërbimeve në nivel shumice, përbën detyrim ligjor dhe sipërmarrësit detyrohen të zbatojnë përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 54/2024, aktet nënligjore dhe ato rregullatore për këtë qëllim.

Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete të komunikimeve publike dhe/ose shërbime telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar të publikojnë në faqen elektronike të tyre

informacionin e përcaktuar në nenin 142 të ligjit nr. 54/2024 dhe Rregulloren “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” lidhur me:

- a) emrin dhe adresën e sipërmarrësit;
- b) përshkrimin e shërbimit të ofruar dhe gatishmërinë gjeografike të shërbimeve (zona e mbulimit me shërbime);
- c) njoftimin e pajtimtarëve për çdo ndryshim të kushteve që kufizojnë aksesin në, dhe/ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikimeve aplikacioneve dhe ku këto shërbime janë të lejueshme sipas ligjeve në fuqi dhe Rregullores “Për masat teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike”.
- d) politikatat e kompensimit/rimbursimit, përfshirë hollësitë specifike të çdo plani të ofruar për kompensim/rimbursim;
- e) llojet e ofruara të shërbimit të mirëmbajtjes;
- f) kushtet e përgjithshme të kontratës Tip, duke përfshirë periudhën minimale kontraktuale, përfundimin e kontratës, procedurat dhe detyrimet e drejtpërdrejta të lidhura me portabilitetin e numrit dhe tregues të tjerë të përcaktuara nga AKEP në Rregulloren “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.
- g) mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara në nenin 46 të ligjit nr. 54/2024 dhe Rregulloren e AKEP “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve të komunikimeve elektronike”.
- h) të drejtat me shërbimin universal, etj.

Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete të komunikimeve publike dhe/ose shërbime telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar:

- a) t’u ofrojnë pajtimtarëve informacion për tarifatat e aplikueshme për çdo numër ose shërbim, subjekt i kushteve të veçanta të tarifimit dhe për kategoritë individuale të shërbimeve ky informacion të ofrohet menjëherë para lidhjes së thirrjes;
- b) të informojë pajtimtarët për çdo ndryshim të aksesit në shërbimet e emergjencës ose të informacionit për vendndodhjen e numrit thirrës në shërbimin ku janë pajtuar;
- c) të informojnë pajtimtarët për çdo ndryshim të kushteve që kufizojnë aksesin në, dhe/ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikacioneve dhe ku këto shërbime janë të lejueshme sipas ligjeve në fuqi;
- d) të ofrojnë informacion për çdo procedurë të vendosur nga ofruesi, në mënyrë që të masë dhe drejtojë trafikun, për të evituar ngarkesën ose mbingarkesën e lidhjeve të rrjetit dhe si këto procedura mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit;
- e) të informojnë pajtimtarët për të drejtën e tyre për të vendosur për të përfshirë ose jo të dhënat e tyre personale në numërat, si dhe llojin e të dhënave, në përputhje me nenin 167 të ligjit nr. 54/2024;
- f) të informojnë rregullisht pajtimtarët me aftësi të kufizuara për detajet e produkteve dhe shërbimeve të projektuara për ata.

Sipërmarrësit, që ofrojnë akses në rrjetet e komunikimeve elektronike publike, mund ta kufizojnë ose ndërpresin përkohësisht aksesin në shërbimet e tyre, pa miratimin paraprak të përdoruesve, në se kjo është e nevojshme për përmirësimin, modernizimin, mirëmbajtjen apo probleme teknike në rrjet.

Sipërmarrësit duhet të informojnë AKEP, për kufizimin ose ndërprerjet e shërbimit:

- i. të paktën 48 orë përpara, në rastin e punimeve të planifikuara për përmirësimin, modernizimin ose mirëmbajtjen e rrjetit, që do të zgjasin më shumë se 30 minuta;
- i. sa më shpejt të jetë e mundur, por në asnjë rast më vonë se 48 orë pas ndodhjes së kufizimit ose ndërprerjes së shkaktuar nga defekte ose dëmtime të rrjetit, kur ndërprerja apo kufizimi impakton njëherazi një numër të konsiderueshëm përdoruesish që vlerësohet me impakt të mesëm ose të lartë.

Sipërmarrësit duhet të njoftojnë për kufizimin ose ndërprerjet e shërbimit, pajtimtarët e prekur:

- ii. të paktën 48 orë përpara, në rastin e punimeve të planifikuara për përmirësimin, modernizimin ose mirëmbajtjen e rrjetit, që do të zgjasin më shumë se 30 minuta;
- iii. sa më shpejt të jetë e mundur, por në asnjë rast më vonë se 48 orë pas ndodhjes së kufizimit ose ndërprerjes së shkaktuar nga defekte ose dëmtime të rrjetit fikse, kur ndërprerja apo kufizimi impakton njëherazi një numër të konsiderueshëm përdoruesish që vlerësohet me impakt të lartë,
- iv. Për shkak të natyrës së shërbimit në rrjetin mobile dhe vështirësive objektive në identifikimin individual të abonentëve të prekur, njoftimi i pajtimtarëve sipas pikës 7/b/, të këtij neni, do të kryhet në përmbushje të parimit “best effort”.

Sipërmarrësit duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që ta bëjnë sa më të shkurtër kohën e kufizimit ose ndërprerjes.

Sipërmarrësit mund ta kufizojnë aksesin në shërbimet e tyre dhe/ose mund ta ndërpresin lidhjen e pajtimtarit, apo mund të ndërpresin kontratën me pajtimtarin vetëm në rast se pajtimtari nuk përmbush kushtet e kontratës, apo nuk kryen pagesat, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Sipërmarrësit duhet të përcaktojnë qartë dhe me detaje kushtet e kontratës rastet kur bëhet kufizimi, ndërprerja e shërbimit apo ndërprerja e kontratës.

Nëse është e mundur teknikisht, operatorët që janë të detyruar të kufizojnë aksesin vetëm për ato shërbime që pajtimtari ka shkelur kushtet e kontratës, përveç rasteve kur pajtimtari abuzon, ose, në mënyrë të përsëritur, kryen me vonesë ose nuk paguan faturat.

Ndalohet të kufizohet aksesin për përdorimin e numrave të emergjencës.

Pajtimtari i aksesit në Internet duhet veçanërisht të njoftohet me mjete elektronike (si p.sh. SMS, mesazh në PC, telefon) kur arrihet niveli 80% i kufizimit “*doënlload/upload*” (nëse ka të tillë). Sipërmarrësi mund të kufizojë shpejtësinë e Aksesit në Internet pas kalimit të kufizimit *doënlload/upload*, për të reduktuar mundësinë e shpenzimeve shumë të larta për pajtimtarin pas tejkalimit të kuotës/limitit

## 12. Shërbimi Universal

Çdo ndërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike zbaton të gjitha detyrimet që mund t'i vendosen lidhur me ofrimin e shërbimit universal në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 54/2024, VKM “Për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal” dhe rregullat e miratuara nga AKEP.

### **13. Mbrojtja e mjedisit, planifikimi territorial, aksesit në pronat e paluajtshme, bashkëvendosja ose përdorimi i përbashkët i pajisjeve**

Rrjetet e komunikimeve elektronike dhe infrastruktura shoqëruese me to duhet të ndërtohen dhe shfrytëzohen në përputhje me ligjin nr. 54/2024 dhe me aktet në zbatim të tij, me legjislacionin në fuqi për planifikimin territorial dhe ndërtimin, për mbrojtjen e mjedisit, si dhe me standardet e tjera teknike.

Sipërmarrësi ka të drejtë të përdorë tokë, troje ose objekte në pronësi të shtetit, përfshirë ndërtesat dhe kanalizimet e ndërtuara mbi ose nën to, të drejtat nënujore dhe ato të hapësirës ajrore, rrugët, liqenet, pyjet etj., për vendosjen e pajisjeve të komunikimeve elektronike, si dhe për mirëmbajtjen e tyre.

AKEP vetë ose, sipas rastit, në bashkëpunim me autoritetet e tjera kompetente, siç specifikohen në nenin 3 të ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, imponojnë bashkëvendosjen dhe bashkëpërdorimin e elementeve të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese të instaluar mbi këtë bazë për të mbrojtur mjedisin, shëndetin publik, sigurinë publike ose për të përmbushur objektivat e planifikimit urban. Sipërmarrësi zbaton rregullat e përcaktuara nga AKEP për ndarjen e kostove të bashkëpërdorimit të faciliteteve të rrjetit ose pronës dhe të koordinimit të punëve civile.

Rrjetet e komunikimeve elektronike publike duhet të planifikohen në mënyrë që të krijojnë sa më pak të jetë e mundur rreziqe dhe shqetësime ndaj pronës private.

Para fillimit të punimeve për ndërtimin ose mirëmbajtjen e rrjetit të komunikimeve elektronike publike, sipërmarrësit duhet të pajisen me lejet përkatëse nga autoritetet kompetente bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 448/ 2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre, në fuqi.

Sipërmarrësi detyrohet të shfrytëzojë pronat e mësipërme, në përputhje me ligjin nr. 10431 datë 9. 6. 2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (ligji nr. 10431) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Me përfundimin e punimeve, kur është objektivisht e mundur, detyrohet ta kthejë mjedisin në gjendjen e mëparshme. Kur nga vendosja ose mirëmbajtja e pajisjeve të komunikimeve elektronike dëmtohet prona ose ndryshon funksioni i saj, sipërmarrësi detyrohet të shpërblejë dëmin, sipas legjislacionit në fuqi.

Sipërmarrësit, janë të detyruar që në rastet e ndërtimit të infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike, të zbatojnë Rregulloren e AKEP “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike” .

Në rastet kur kërkohet përdorimi ekonomik i hapësirave, planifikimi urban dhe mbrojtja e mjedisit, sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve publike elektronike, që kanë të drejtë të ndërtojnë dhe instalojnë pajisje komunikimi në mjedise private ose publike duhet t'i ndërtojnë ose instalojnë ato, për të mundësuar përdorimin e përbashkët të tyre. Për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike sipërmarrësit janë të detyruar të zbatojnë rregulloren për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike.

Sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimeve janë të detyruar të lidhin marrëveshje për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve në kushtet e përcaktuara në pikën e mësipërme. Kur sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimit nuk arrijnë marrëveshje ndërmjet tyre, AKEP me kërkesë të çdo pale, ndërmerr një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas përcaktimeve të parashikuara në Rregulloren për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe akteve rregullatore në fuqi për këtë qëllim.

Sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve publike kanë detyrimin për dërgimin e informacionit në AKEP mbi infrastrukturën e rrjeteve dhe faciliteteve shoqëruese dhe përditësimin e tij në përputhje me rregulloren “Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrimit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

#### **14. Detyrimi për lejimin e inspektimit**

Zbatimi i kushteve të përgjithshme dhe/ose specifike nga sipërmarrësi, përbën objekt të mbikëqyrjes, kontrollit dhe monitorimit nga AKEP në mbështetje të kompetencës ligjore të përcaktuar në nenin 12 të ligjit nr. 54/2024, në kuadër të ushtrimit të inspektimit të veprimtarisë sipas neneve 181-185 e vijues të këtij ligji, rregullores së AKEP “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” dhe rregullores “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”.

Sipërmarrësi ose çdo person tjetër, fizik apo juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, është i detyruar t'i lejojë inspektorët e AKEP të kryejnë inspektimin kudo ku ka pajisje të komunikimeve elektronike, si dhe t'i ofrojnë inspektorëve të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar prej tyre.

Kur inspektorët e AKEP, vërtetojnë se një sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike ose çdo person tjetër fizik apo juridik, që ushtron veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, ka shkelur ligjin nr. 54/2024, dhe rregulloret e nxjerra nga AKEP në zbatim të tij, merren masat administrative të parashikuara në nenin 184 të ligjit nr. 54/2024.

## KUSHTET E SPECIFIKE

### 1. Detyrimi për akses dhe interkoneksion

Sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike kanë të drejtë, edhe kur kërkohet nga një sipërmarrës tjetër i autorizuar në përputhje me këtë ligj, kanë detyrimin për të negociuar me njëri-tjetrin për interkoneksionin, me qëllim ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, në mënyrë që të sigurohet ofrimi dhe ndërveprueshmëria e shërbimeve.

Sipërmarrësit duhet të ofrojnë akses dhe interkoneksion për sipërmarrësit e tjerë, me terma dhe kushte në përputhje me detyrimet e vendosura nga AKEP-i, në bazë të kreut XIII dhe të nenit 92 të ligjit nr. 54/2024.

Çdo sipërmarrës i rrjeteve të komunikimeve elektronike brenda 30 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë ofron një ofertë interkoneksioni për sipërmarrjet e tjera të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, për të siguar komunikimin e përdoruesve, ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe ndërveprueshmërinë e shërbimeve.

Pavarësisht nga e drejta e sipërmarrjeve për të negociuar lirisht ndërmjet tyre, kur e kërkojnë kushtet e konkurrencës, negociatat zhvillohen përmes një ndërmjetësi neutral, me miratimin e AKEP-it. Palët e interesuara dorëzojnë në AKEP informacionin përkatës për t'u dokumentuar.

Çdo sipërmarrës i autorizuar nga AKEP-i për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, ka të drejtë të negociojë interkoneksionin dhe të marrë akses ose të interkonektohet me sipërmarrës të tjerë që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm.

Procedura dhe rregullat për aksesin dhe interkoneksionin zbatohen nga sipërmarrësit në përputhje të plotë me ligjin nr. 54/2024 dhe dokumentet rregullatore të nxjerra dhe miratuara nga AKEP-i:

- i) Rregullore “Për aksesin dhe interkoneksionin”
- ii) RIO e publikuar e operatorëve me FNT
- iii) RUO e publikuar e operatorëve me FNT
- iv) çdo vendim i AKEP-it i nxjerrë për këtë qëllim

Për realizimin e interkoneksionit dhe/ose aksesit sipërmarrësit lidhin midis tyre marrëveshje interkoneksioni dhe/ose aksesit, një kopje e të cilave depozitohet në AKEP brenda 15 ditëve nga data e lidhjes së tyre.

Në çdo rast, marrëveshjet e interkoneksionit dhe aksesit duhet të jenë në përputhje me ligjin nr. 54/2024, legjislacionin në tërësi dhe aktet e AKEP-it për këtë qëllim.

Çdo sipërmarrës i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, duhet që, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë, t'u japë një ofertë interkoneksioni (RIO) sipërmarrësve të tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, që të sigurojë komunikimin e përdoruesve, ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe bashkëveprimin e shërbimeve në të gjithë

komunitetin.

AKEP, në përputhje me objektivat rregullatorë nxit dhe nëse është e nevojshme, detyron realizimin e aksesit dhe interkoneksionit, si dhe bashkëveprimin e shërbimeve, duke synuar nxitjen e konkurrencës së qëndrueshme dhe efçente, për përfitimin maksimal të përdoruesve fundorë.

Pavarësisht nga masat që mund të merren ndaj sipërmarrësve me FNT, AKEP vendos:

- a) për sa është e nevojshme, detyrimet për sigurimin e lidhjes pikë fundore – pikë fundore ndaj sipërmarrësve, që i nënshtrohen autorizimit të përgjithshëm dhe që kontrollojnë aksesin te përdoruesit fundorë, duke përfshirë në rastet e justifikuara detyrimin për interkonektimin e rrjeteve të tyre;
- b) në raste të justifikuara dhe në masën e nevojshme, detyrimet ndaj sipërmarrësve që i nënshtrohen autorizimit të përgjithshëm dhe që kontrollojnë aksesin e përdoruesve fundorë për t'i bërë shërbimet e tyre të ndërveprueshme;
- c) në raste të justifikuara kur lidhja pikë fundore – pikë fundore ndërmjet përdoruesve fundorë rrezikohet për shkak të mungesës së ndërveprimit, ndërmjet shërbimeve të komunikimit ndërpersonal dhe në masën e nevojshme për të siguruar lidhjen pikë fundore – pikë fundore ndërmjet përdoruesve fundorë, detyrimet mbi ofruesit përkatës të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri, të cilët arrijnë një nivel të konsiderueshëm mbulimi dhe pranimi nga përdoruesit për t'i bërë shërbimet e tyre të ndërveprueshme;
- d) në masën e nevojshme sigurimin e aksesit të përdoruesve fundorë në shërbimet radiodigjitale dhe shërbimet plotësuese përkatëse, të specifikuara në legjislacionin në fuqi, detyrimet e operatorëve për të siguruar akses në objektet e tjera me kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

Caktimi i kodeve të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC):

- a) Sipërmarrësi që kërkon të ofrojë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike, përpara fillimit të ofrimit të tyre, për realizimin e interkoneksionit duhet të pajiset me NSPC.
- b) Nëse sipërmarrësi do ta realizojë interkoneksion ndërkombëtar bazuar në sinjalizimin SS7, atëherë, duhet detyrimisht të pajiset edhe me kodin ISPC.
- c) Caktimi nga AKEP-i i NSPC dhe ISPC bëhet mbi bazën e Rregullores “Rregullat për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”.
- d) Për caktimin nga AKEP të NSPC dhe ISPC, sipërmarrësi duhet të aplikojë njëkohësisht me fillimin e aplikimit për Njoftim regjistrimi, përcaktuar në këtë rregullore. Për caktimin e ISPC sipërmarrësi përpara fillimit të aplikimit duhet të ketë siguruar dhe disponojë një marrëveshje paraprake me operatorin/ët ndërkombëtarë ku do të jetë vendosur edhe ISPC që disponon ky operator ndërkombëtar.
- e) Sipërmarrësit e pajisur nga AKEP-i me NSPC dhe ISPC, duhet të përdorin kodet e caktuar nga AKEP në përputhje me kushtet e vendosura në vendimet përkatëse të AKEP-it, Rregullat për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve, dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje si dhe detyrimet financiare përkatëse.

## **2. Masat për mbrojtjen e shëndetit publik kundrejt fushave elektromagnetike**

Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike janë të detyruar të sigurojnë mbrojtjen e shtetasve ndaj veprimeve të dëmshme të rrezatimit elektromagnetit të përhapur nga rrjetet e komunikimeve elektronike në përputhje me ligjin nr. 54/2024, ligjin “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, në fuqi, ligjin “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, VKM nr.743, datë 16.10.2012, “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese” dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike, për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve kanë detyrimin e zbatimit të rregullit teknik në përputhje me VKM nr. 378, datë 05.06.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, e ndryshuar, për kërkesat mbrojtëse lidhur me pajtueshmërinë elektromagnetike, sipas legjislacionit në fuqi për përputhshmërinë elektromagnetike. Pajisja radio sipas përcaktimeve në VKM nr. 378/2019, e ndryshuar, e cila është importuar dhe e vendosur në treg dhe/ose në shërbim, nuk duhet të krijojë fusha elektromagnetike mbi vlerat e parashikuara në rregulloret e pajisjeve radio dhe pajisjeve fundore të telekomunikacioneve.

Vlerat limit të fushës elektromagnetike, vlerat limit të fuqisë së rrezatuar, si dhe kushte të tjera, të cilat duhet të plotësohen nga aparatet si burim i rrezatimit elektromagnetik të radiofrekuencave duhet të jenë sipas vlerave të miratuara.

## **3. Mirëmbajtja e integritetit të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike**

Sipërmarrësi mban dokumentacion të plotë e të saktë për rrjetin e vet. Me kërkesë zyrtare, sipërmarrësit u japin organeve të ngarkuara me ligj për planifikimin urban dhe njëri-tjetrit të dhëna për pjesë të këtij rrjeti, për të shmangur dëmtimin e rrjetit nga punimet nëntokësore apo ndërtimore ose nga ndikimet e mundshme elektrike, që shkakton vënia në punë e pajisjeve të tjera pranë rrjetit të komunikimeve elektronike.

Sipërmarrësi detyrohet të mbajë pajisjet e komunikimeve elektronike në gjendje të mirë pune, duke respektuar kushtet teknike dhe standardet përkatëse.

Gjatë përmbushjes së detyrave për mirëmbajtjen e pajisjeve të komunikimeve elektronike, punonjësit e autorizuar nga sipërmarrësi kanë të drejtë të hyjnë në pronat publike dhe private, për të kryer punimet e nevojshme dhe për të vënë shenjat e ndryshme, që tregojnë praninë e objekteve të komunikimeve elektronike.

Për të siguruar funksionimin normal të pajisjeve të komunikimeve elektronike, sipërmarrësi ka të drejtë të presë pemët, shkurret, degët e rrënjët, që rrezikojnë pajisjet e mësipërme, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore, si ligji nr. 120/2016, ligji nr. 10 448, ligji 107/2014 dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

Mirëmbajtja e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe infrastruktura shoqëruese me to duhet të jenë në përputhje me rregullat e ndërtimit për:

- a) përfundimin dhe përmirësimin e faciliteteve ekzistuese dhe të pajisjeve të rrjeteve publike të komunikimit;
- b) rindërtimin e sistemeve të antenave ekzistuese;
- c) rinovimin dhe rindërtimin e faciliteteve ekzistuese të rrjeteve të komunikimeve elektronike;
- d) zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese apo instalimin e sistemeve të reja të komunikimit dhe rrjetet e aksesit publik;
- e) zgjerimin e sistemeve ekzistuese të furnizimit me energji elektrike.

#### **4. Siguria e rrjeteve publike kundrejt aksesit të paautorizuar**

Sipërmarrësit duhet të marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme ndaj sistemeve të komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave, për të mbrojtur sekretin e komunikimeve elektronike dhe të të dhënave personale nga aksesit i paautorizuar i sistemeve të komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave.

Sipërmarrësit, përpara fillimit të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, së bashku me informacionin për regjistrimin e Njoftimit, paraqesin në AKEP edhe informacionin mbi masat që do të zbatohen për mbrojtjen e rrjetit për të ndaluar aksesin e paautorizuar sipas rregullores së AKEP “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

Pas fillimit të ofrimit të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, AKEP kryen verifikimin e zbatimit nga sipërmarrësi të masave mbrojtëse për të ndaluar aksesin e paautorizuar sipas dokumentit të depozituar në AKEP.

#### **5. Kushtet e përdorimit të frekuencave**

Dhënia në përdorim dhe përdorimi i frekuencave bëhet nga AKEP në përputhje me përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 54/2024, Planin Kombëtar të Frekuencave (PKF), Planin e Përdorimit të Frekuencave (PPF), si dhe aktet e ITU dhe ECA – Tabela për Përcaktimin e Përbashkët Evropian të Frekuencave.

Personat fizikë apo juridikë mund të përdorin frekuenca vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht, me autorizim nga AKEP sipas përcaktimeve të ligjit nr. 54/2024 dhe Rregullores së AKEP “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”.

E drejta e përdorimit të frekuencave kufizohet vetëm në rast se kjo kushtëzohet nga pamjaftueshmëria e frekuencave dhe nga detyrimi për të siguruar përdorimin eficient të tyre.

Për përdorimin e frekuencave të caktuara në PKF, për qëllime të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së vendit, nuk do të kërkohet autorizim nga AKEP.

Disa frekuenca mund të përdoren pa autorizim, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 54/2024, rregullat e ITU dhe Rregullores së AKEP “Për kushtet e përdorimit të frekuencave të pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza”.

Kur përdorimi i frekuencave është subjekt i një konkurrimi publik sipas nenit 75 dhe 76 të ligjit nr. 54/2024, frekuencat jepen nga AKEP në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë ligj dhe sipas rregullave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave për këtë qëllim.

Kur përdorimi i frekuencave është subjekt i një konkurrimi publik sipas nenit 75 dhe 76 të ligjit nr. 54/2024, frekuencat jepen nga AKEP në përputhje me procedurën e përcaktuar në VKM 496, datë 22. 7. 2014 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” të ndryshuar.

Kushtet, që duhet të plotësohen nga përdoruesi, për shfrytëzimin e frekuencave, zbatohen edhe për shërbimet e komunikimeve elektronike, ose rrjetet e komunikimeve elektronike, për të cilat janë dhënë frekuencat. Sipërmarrësit zbatojnë kushtet e shfrytëzimit të frekuencave të vendosura nga AKEP si më poshtë:

- a) Kërkesat në lidhje me mbulimin dhe fortësinë e sinjalit, fuqinë e transmetimit;
- b) kushtet teknike të funksionimit, të nevojshme për shmangien e interferencave të dëmshme dhe kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike;
- c) afatin e vlefshmërisë së përdorimit të frekuencave;
- d) transferimin e të drejtave të pronësisë për përdorimin e frekuencave dhe kushtet për transferim;
- e) kryerjen e pagesave;
- f) detyrime të tjera, të marra përsipër nga fituesi gjatë pjesëmarrjes në tenderin publik si dinamika e ngritjes së rrjetit, zonat e mbulimit, etj.;
- g) detyrime për aktet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- h) detyrime nga marrëveshjet e lidhura nga AKEP me organet rregullatore të vendeve fqinje për shmangien e interferencave në zonat kufitare etj.

Një sipërmarrës, mbajtës i autorizimit individual për përdorimin e spektrit të frekuencave, mund të transferojë ose t’i japë me qira një sipërmarrësi tjetër të drejtat e përdorimit të frekuencave, pas miratimit nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të nenit 71 të ligjit 54/2024.

Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave mund të ndryshohet nga AKEP me nismën e vet ose kërkesën e mbajtësit të tij, në rastet e përcaktuara në nenin 38 të ligjit nr. 54/2024.

Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave mund të revokohet nga AKEP me nismën e vet ose kërkesën e mbajtësit të tij, në rastet e përcaktuara në nenin 40 të ligjit nr. 54/2024.

Me kërkesë të mbajtësit të autorizimit individual, vlefshmëria e autorizimit mund të shtyhet vetëm në rast se në përfundim të këtij afati janë përmbushur të gjitha kushtet e përdorimit të këtyre frekuencave.

Rregullat dhe procedura për rinovimin e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Çdo sipërmarrës:

- a) është i detyruar të përdori gjatë ndërtimit të rrjetit dhe ofrimit të shërbimeve të

komunikimeve elektronike, pajisje radio të prodhuara në mënyrë të tillë që të lejojnë përdorim efektiv të spektrit që i është caktuar, me qëllim që të shmangi çdo interferencë të dëmshme.

- b) është i detyruar të bashkëpunojë me cilindo sipërmarrës tjetër që përdor radiofrekuenca të caktuara nga AKEP-i, në mënyrë që të eliminohet çdo interferencë e dëmshme që mund të preki cilësinë e shërbimeve të komunikimeve elektronike që i ofrohen përdoruesve, ose të eliminojë çdo interferencë të dëmshme që mund t'ju jetë shkaktuar stacioneve të radiokomunikimit që operojnë në mënyre legale brenda territorit të Shqipërisë ose në vendet fqinje.

Në qoftë se AKEP konstaton se një interferencë e dëmshme është shkaktuar tek stacionet e radiokomunikimit ose përdoruesit për shkak të moszbatimit të kushteve dhe specifikimeve të frekuencave të caktuara, ose për shkak të keqfunksionimit të pajisjeve të tij, sipërmarrësi është i detyruar të ndërpresë funksionimin e sistemit të tij, menjëherë pas marrjes së njoftimit. Në rast të kundërt, ndaj tij aplikohen sanksionet e parashikuara nga ligji nr. 54/2024.

Cilido sipërmarrës është i detyruar të zbatojë standardet e pajisjeve të përcaktuara nga autoritetet kompetente shqiptare dhe ETSI në lidhje me këto pajisje, si dhe kriteret përkatëse të përcaktuara nga AKEP-i lidhur me karakteristikat e transmetimit, në mënyrë të tillë që të sigurojë bashkekzistencën efektive dhe të harmonizuar të të gjithë aplikimeve të telekomunikacioneve pa tela në të njëjtën frekuencë apo në frekuenca fqinje. Sipërmarrësi duhet të zbatojë kushtet teknike të vendosura në autorizimin individual me të cilin është pajisur.

Cilido sipërmarrës duhet të sigurojë që rrjeti i tij është projektuar, instaluar, mirëmbajtur dhe funksionon në mënyrë të tillë që të mos shkaktojë çfarëdo interference të dëmshme ndaj sipërmarrësve të tjerë ose përdoruesve të ligjshëm të spektrit të frekuencave.

AKEP monitoron përdorimin e frekuencave në përputhje me Rregulloren “Për monitorimin e spektrit të frekuencave” dhe zbaton sanksionet e parashikuara në ligjin nr. 54/2024 në rast të përdorimit të tyre në kundërshtim me ligjin nr. 54/2024, aktet nënligjore dhe rregullatore, si dhe autorizimit individuale të lëshuara nga AKEP për këtë qëllim.

Mbajtësit e të drejtave për përdorimin e frekuencave paguajnë pranë AKEP një pagesë vjetore për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, neni 19 i ligjit 54/2024. Niveli i pagesës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fituesi së drejtës për përdorimin e frekuencave, që jepet me procedurën e konkurrimit publik, sipas nenit 76 të ligjit nr. 54/2024, kryen një pagesë për frekuencat në vlerën e arritur në procesin e konkurrimit, e cila derdhet në Buxhetin e Shtetit (pika 9 e nenit 75 të ligjit nr. 54/2024).

Sipërmarrësit nuk mund të refuzojnë, për arsye teknike, një kërkesë të arsyeshme për lidhjen e një pajisjeje radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve. Rregullat teknike për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve përcaktohen në VKM nr.378, datë 05.06.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, e ndryshuar dhe Rregulloren “Për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”.

## **6. Sigurimi i disponueshmërisë dhe kushtet e përdorimit të numeracionit**

Numrat për akses në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike janë burime natyrore të fundme dhe për këtë qëllim administrimi i tyre duhet të sigurojë përdorim eficient, në përputhje edhe me vendimet përkatëse të organizmave ndërkombëtare dhe detyrimet që rrjedhin nga konventat ose nga marrëveshjet, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Plani i numeracionit përcakton strukturën, gjatësinë dhe caktimin e numrave për akses në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.

AKEP administron planin e numeracionit në mënyrë që:

- a) të sigurojë strukturimin dhe përdorimin eficient të numrave dhe serive numerike;
- b) të kënaqë nevojat e arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave, sipas këtij ligji;
- c) të sigurojë që caktimi dhe përdorimi i numrave bëhet në mënyrë të ndershme, transparente dhe jodiskriminuese.

Numrat dhe seritë numerike përdoren vetëm pas miratimit nga AKEP, në përputhje me rregullat përkatëse.

Në rast se sipërmarrësi për ofrimin e rrjeteve dhe ose shërbimeve elektronike publike do të përdorë numra dhe seri numerike, atëherë së bashku me njoftimin për regjistrim duhet të aplikojë në AKEP-i sipas Rregullores “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”.

Mbajtësi i autorizuar nga AKEP i të drejtës së përdorimit të numrave është i detyruar t’i përdori ato vetëm sipas kushteve të vendosura nga AKEP në përputhje me ligjin nr. 54/2024, Planin Kombëtar të Numeracionit dhe Rregulloren “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”.

Mbajtësi i autorizuar nga AKEP i të drejtës së përdorimit të numrave:

- a) është i detyruar të kthejë numrat apo seritë numerike të caktuara, në rast se ato nuk janë në përdorim;
- b) nuk mund të përdorë numrat dhe seritë numerike, të caktuara për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë dhënë;
- c) nuk mund të transferojë apo t’i japi me qira numrat apo seritë e numrave të caktuara, pa miratimin paraprak të AKEP;
- d) mund t’i transferojë numrat dhe seritë numerike të caktuara së bashku me veprimtarinë e ushtruar, kur mbajtësi i ri përmbush kërkesat për përdorimin e numrave dhe të serive numerike, në përputhje me vendimet e AKEP;
- e) është i detyruar të paguajë pagesat për numeracion, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- f) duhet të përmbushi kërkesën për transferimin e numeracionit në të gjitha rastet kur kërkohet një gjë e tillë;
- g) është i detyruar të përdorë numrat apo seritë e numrave vetëm për qëllimin për të cilin i janë dhënë dhe të mos i shkaktojë dëm ndonjë grupi të caktuar përdoruesish;
- h) të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, për caktimin dhe përdorimin e numrave.
- i) të mos bëjë diskriminime të pajustificuara lidhur me sekuencën e numrave dhe grupeve të

numrave ndërmjet pajtimtarëve.

Në përputhje me nenin 136, pika 1 të ligjit nr. 54/2024, AKEP, mund të heqë të drejtën për përdorim të numrave dhe serive të numrave në rast se vëren se mbajtësi të drejtës për përdorim të numrave dhe serive numerike:

- a) nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 54/2024 për caktimin e numrave dhe serive numerike;
- b) nuk ka kryer në kohë pagesën vjetore për përdorimin e numrave dhe të serive numerike;
- c) nuk ka filluar t'i përdorë ato brenda 3 vjetëve nga data e caktimit të tyre<sup>16</sup>.
- d) mbajtësi i të drejtave është cregjistruar ose ka pezulluar aktivitetin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

AKEP mund ta heqë të drejtën për përdorim të numrave dhe serive numerike me kërkesë të mbajtësit të së drejtës për përdorimin e numrave apo serive numerike.

Mbajtësit e të drejtave për përdorimin e numrave dhe të serive numerike paguajnë pranë AKEP një pagesë vjetore për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike, sipas neni 19 të ligjit nr. 54/2024. Niveli i pagesës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **7. Portabiliteti i numrave**

Sipërmarrësit kanë detyrim që t'u mundësojnë të gjithë përdoruesve fundorë, që kanë numra nga Plani Kombëtar i Numeracionit dhe të cilët kërkojnë të ruajnë numrat e tyre, pavarësisht nga sipërmarrësi që ofron shërbimin, që të bartin numrat:

- a) në rastin e numrave gjeografikë – në një vendndodhje të caktuar;
- b) në rastin e numrave jogjeografikë – në çdo vendndodhje.

AKEP në zbatim të detyrimit ligjor, nëpërmjet Rregullores “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” ka përcaktuar mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit.

## **8. Mbrojtja e konsumatorit**

Sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike kanë detyrimin ligjor të mbrojtjes së konsumatorit në përputhje me përcaktimet e parashikuara në kreun XVIII të ligjit nr. 54/2024, ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, në fuqi dhe Rregullores së AKEP Për “Mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.

Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike duhet të publikojnë informacion transparent, të krahasueshëm, të përshtatshëm dhe të përditësuar për tarifën dhe çmimet e aplikuar, çdo detyrim në përfundim të kontratës, si dhe kushtet e përgjithshme për aksesin e përdorimit të shërbimeve të ofruara nga ata për përdoruesit fundorë në përputhje me ligjin nr. 54/2024 dhe Rregulloren “Mbi publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

---

<sup>16</sup> Sipërmarrësit e pajisur me të drejta përdorimi për burimet e numeracionit nuk i nënshtrohen afatit 12 muajor të përcaktuar në nenin 9 të kësaj rregulloreje

Lidhja ose aksesi në rrjetin publik të komunikimeve elektronike sigurohet nga sipërmarrësit në bazë të kontratës që lidhet me pajtimtarët sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 54/2024 dhe Rregulloren “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, si dhe bazohet në parimin e barazisë mes palëve.

Një kopje tip e kontratës së pajtimit, si dhe çdo ndryshim i mëvonshëm që mund të pësojë, i dërgohet AKEP-it 15 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre.

Sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe/ose distributorët e autorizuar prej tyre për shitjen e kartave SIM, përpara aktivizimit të shërbimit detyrohen të bëjnë regjistrimin e pajtimtarëve të tyre, me kontratë pajtimi ose kartë të parapaguar. Formulari i regjistrimit nga sipërmarrësit të të dhënave të identifikimit të pajtimtarit, përcaktohet dhe miratohet nga AKEP në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 54/2024.

Sipërmarrësit janë të detyruar të zbatojnë kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 54/2024 dhe/ose legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktet e nxjerra nga AKEP lidhur me:

- a) Ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për qëllime të ndjekjes penale;
- b) Shkatërrimin e të dhënave të ruajtura;
- c) Garantimin e aksesit të barabartë dhe mundësisë së zgjedhjes për përdoruesit me aftësi të kufizuara;
- d) Publikimin e informacionit të duhur, të krahasueshëm dhe të përditësuar për cilësinë e
- e) shërbimeve të ofruara prej tyre, *speed test* për matjen e kapacitetit *Broadband* të ofruar, etj.;
- f) Përfshirjen e pajtimtarit në numratorin telefonik të përgjithshëm;
- g) Organizimin dhe funksionimin e shërbimit të asistencës ndaj përdoruesve fundorë. Të gjithë përdoruesit fundorë, që kanë akses në rrjetin e komunikimeve elektronike publike, duhet të kenë akses në shërbimet e asistencës së sipërmarrësit;
- h) Ofrimin pa pagesë pajtimtarëve të shërbimeve të ofruara prej tyre të faturës së detajuar me qëllim që t’u mundësojnë kontrollin mbi shumën e faturuar;
- i) Sigurimin e ushtrimit të të drejtës së ankimit të pajtimtarit për kushtet kontraktore dhe/ose përmbushjen e këtyre kushteve, përfshirë faturën dhe cilësinë e shërbimit të ofruar.

Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike publike, pa përjashtim, përpara fillimit të ofrimit të shërbimit, kanë detyrimin e ndërtimit dhe ofrimit të faqes elektronike (ëëë...) për publikimin e informacionit të kërkuar sipas ligjit nr. 54/2024 dhe legjislacionit të përgjithshëm.

Çdo ofrues i shërbimeve publike telefonike duhet të sigurojë ekzistencën e procedurave për shqyrtimin e problemeve që hasen nga konsumatorët dhe duhet të ketë departamentet e shërbimit të konsumatorit ose personel të trajnuar në mënyrë të duhur dhe speciale në pikat e tij të shitjes.

Sipërmarrësit e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike duhet të kenë procedura të përcaktuara qartë për trajtimin e ankesave të pajtimtarëve, përfshirë këtu edhe pajtimtarët me aftësi të kufizuara.

Në bashkëpunim edhe me AKEP, ofruesit e shërbimit publik telefonik duhet të bëjnë një grupim të problemeve/pyetjeve që janë drejtuar tek departamenti i shërbimit të konsumatorit nga përdoruesit dhe duhet të trajtojë personelin e shërbimit të konsumatorit që të jetë i aftë të trajtojë efektivisht, në mënyrë të standardizuar, të paktën çështjet e ndeshura me shpesh të përfshira në cilëndo kategori.

Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike duhet të raportojnë çdo vit pranë AKEP-it lidhur me veprimtarinë e tyre për trajtimin e ankesave të shqyrtuara, shoqëruar me statistikat përkatëse.

Ndër të tjera, ofruesit e shërbimit publik telefonik duhet t'i shërbejnë përdoruesit lidhur me çështjet e defekteve nëpërmjet një linje speciale pa pagesë e cila të punojë të paktën 12 orë në ditë, nga e hëna deri të shtunë

## **9. Respektimi i kufizimeve në lidhje me transmetimet e përmbajtjeve të paligjshme ose përmbajtjes së dëmshme**

Sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike kanë detyrimin ligjor për respektimin e kufizimeve në lidhje me transmetimet e përmbajtjeve të paligjshme ose përmbajtjes së dëmshme, bazuar në legjislacionin në fuqi.

AKEP, me disponimin e kërkesës së organit kompetent të fushës për kufizimin e transmetimit me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, i drejtohet sipërmarrësve që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, për ndërprerjen dhe bllokimin e transmetimit të kësaj përmbajtje.

Me marrjen e kërkesës nga AKEP për ndërprerjen/kufizimin e transmetimit me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, sipërmarrësit janë të detyruar që të marrin masat e duhura ligjore dhe teknike për zbatimin e kufizimit të kërkuar.